

U1-46/107b
dt. 12.10.2015

RAPORT

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS PËR NDËRTIMIN E RRJETIT TU ME KABËLL ABC NË ZONËN KËNETA E DURRËSIT

Përgatitur nga Shoqeria "KULD"sh.p.k

Autorë:

M. Sc. Marianthi
Ing. Dipl. Llazar
Dr.in proc. Aulent
Ark. Kris

GURI (EKSPERT GJEO-MJEDISI)
SHANDRO (EKSPERT ELEKTRIK)
GURI (EKSPERT GJEOGRAF MJEDISI)
TIRANA (EKSPERT URBANE)



Tiranë, Tetor - 2015

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
Hyrje	6
I. RAPORT TEKNIK I PROJEKTIT	8
1.1 QËLLIMI I PROJEKTIT	8
1.2. PREZANTIMI I PROJEKTIT.....	8
1.3. PËRSHKRIMI I PUNIMEVE TEKNIKE	9
1.4. PËRSHKRIMI I VEND-NDODHJES	12
1.5 INFORMACION PËR QËNDRAT E BANUARA	14
1.6. SKICAT DHE PLANIMETRIKË E OBJEKTEVE	25
1.7 PËRSHKRIM I PROÇESEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE	34
1.8 INFORMACION PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME	36
II. RAPORTI PARAPRAK I VNM-së	44
2.1. NATYRA E VNM	44
2.2. PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	44
2.3. QËLLIMI I VNM	45
2.4. METODIKA	45
2.5. KËRKESAT E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË MJEDIS	46
2.6. ANALIZA E ALTERNATIVAVE	48
2.7. PLANI I DREJTIMIT MJEDISOR	48
III. KORNIZA LIGJORE EKZISTUESE.....	50
3.1. SHQYRTIMI LEGJISLATIV, RREGULLATOR DHE I POLITIKAVE	50
3.2. LIGJET, VENDIMET DHE UDHËZIMET E VITEVE TË FUNDIT (2011 -2015)	53
IV. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME.....	55
4.1. VLERËSIMI DHE IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE DHE POZITIVE	55
4.2. ANALIZA DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE SIPAS ALTERNATIVAVE	58
V. ANALIZA E NDIKIMEVE NË MJEDIS DHE SHËNDETIN NJERËZOR	63
5.1. ANALIZA E NDIKIMEVE NË MJEDIS	63
5.2. ANALIZA E NDIKIMIT TE FUSHES ELEKTROMAGNETIKE NË MJEDIS	64
5.3. ANALIZA E RREZIKUT TE FUSHES ELEKTROMAGNETIKE NË SHËNDET	67
5.4. STANDARTET E SOTME TE FUSHES ELEKTROMAGNETIKE.....	69
5.5. ANALIZA E NDIKIMEVE TË ZHURMAVE NË SHËNDET.....	70
VI. PLANI I ZBUTJES SË NDIKIMEVE NEGATIVE	71
6.1. PLANI I MENAXHIMIT TË AMBIENTIT	71
6.2. MASAT E SHMANGIES SE NDOTJES SË AJRIT	72
6.3. MASAT E SHMANGIES SE NDOTJES SË UJRAVE SIPËRFAQËSORE	72
6.4. MASAT E SHMANGIES SE NDIKIMEVE NEGATIVE NË BIODIVERSITET	72
6.5. MASAT E SHMANGIES SE NDIKIMEVE NË INTENSITETIN E EROZIONIT	73
6.6. MASAT NE REDUKTIMIN E MBETJEVE DHE EMETIMEVE NË MJEDIS	73
6.7. MASAT NE MBROJTJEN NGA AKSIDENTET NË PUNË	74
6.8. MASAT SOCIAL-EKONOMIKE	74
VII. MASAT KOMPESUESE DHE MONITORIMI	75
7.1. MASAT KOMPESUESE	75
7.2. PLANI I MONITORIMIT	76
7.3. PLANI I PJESËMARRJES PER KONSULTIMIN PUBLIK DHE PREZANTIMI I PLANIT	80
VIII. VLERESIMI I RREZIQEVE GJEO-NATYRORE.....	81
8.1. VLERESIMI I GJEORREZIQEVE NATYRORE	81
8.2. VLERESIMI I RREZIQEVE TE TJERA TË MUNDSHME	86
IX. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	88
9.1. PËRFUNDIME	88
9.2. REKOMANDIME	91
X. STUDIMET MBESHTETESE	92

PARATHËNIE

Shqipëria, si palë nënshkruese e një numri konventash ndërkombëtare, kontratave dhe dokumentave të tjera ligjore (Ramsari, Barcelona, Konventa e Biodiversitetit), është e detyruar të zbatojë një sistem efektiv për administrimin e tokës, ujit dhe ajrit, jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së problemit, por edhe të zbatimit të përgjegjësive të këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare. Një ndër burimet e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit janë zhvillimet teknologjike, që sipas natyrës dhe mënyrës teknike të aplikuar shkaktjnë ndotje, me sasi dhe natyra të ndryshme, midis të cilave më të rëndësishme janë:

- Gjatë operacioneve të punimeve të ndërtimeve të ndryshme;
- Sistemi i mbrojtës nga përmbytjet dhe rreziqet e mundshme natyrore;

Mbrojtja e mjedisit, si një sistem dinamik, që ndryshon herë pas here fizikisht dhe biologjikisht, duhet parë në tërësinë e faktorëve natyrorë dhe të veprimit njerëzor që ushtrohet mbi të. *Punimet për investimin: "Ndërtimi i rrjetit TU me kabëll ABC në zonën Kënetë e Durrësit, japin një ndikim të caktuar, duke goditur pak a shumë natyrën përreth, sidomos kur parametrat e organizimit të saj nuk analizohen konform ligjeve e rregullave të natyrës, në dobi të ruajtjes së ekuilibrave e të ekosistemeve të saj. Metodatat e uljes së ndotjes, në punimet për Ndërtimin e rrjetit TU me kabëll ABC në zonën Kënetë e Durrësit, konsistojnë në perfeksionimin e teknikave të menaxhimit të punimeve gjatë montimit të tyre, por mbi të gjitha në marrjen e masave kundrejt atyre faktorëve që mund të "vrasin" projektet ose e kundërta, në zbutjen e ndikimeve negative ndaj parametrave natyrorë e shëndetësor. Nxitja e tyre kërkon një përkujdesje më të madhe nga ana e organeve legjislativë dhe vendimmarrëse, në mënyrë që të rritet interesi për ngritje të tilla, si dhe shoqëria investuese duhet të tregojë interes, në ruajtjen e ekuilibrave natyrorë, dhe veçanërisht në ruajtjen e ekosistemeve. Në rastin konkret do të kemi vetëm ndotje në formë grimcash pluhuri që do të gjenerohen nga hapja dhe mbyllja e gropave, ku do të montohen *Shtyllat*, dhe ndërtimi i rrjetit TU me kabëll ABC. Është menduar që gjatë gjithë kohës së punimit për hapjen dhe më pas mbylljen e gropave ku do të montohen *Shtyllat* dhe ndërtimi i rrjetit TU, toka të spërkatet me ujë si edhe të izolohet ambienti rrethues duke mos lejuar krijimin e pluhurave. Kjo është një nga detyrat kryesore që duhet marrë parasysh edhe në kuadër të ruajtjes së mjedisit dhe shëndetit të punonjësve dhe banorëve aty pranë.*

FALENDERIME

Së pari, falenderojmë OSHEE, sh.a. – DURRES për lehtësirat që na krijoi në fushën e bashkëpunimit me ekspertët lokal dhe sigurimin e informacionit bazë të nevojshëm, për kryerjen e studimit *“Raport i Ndikimit të Ndotjes së Mjedisit (VNM)”*.

Falenderojmë dhe vetë specialistët edhe ekspertët e OSHEE -së, për bashkëpunim të frytshëm në sigurimin e të dhënave bazë dhe disa treguesve e parametrave të domosdoshëm për përpilimin e Raportit –VNM.

Falenderojmë gjithashtu specialistët për diskutimet dhe rekomandimet me vlerë, që ballafaquam gjatë përpilimit të tekstit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

HYRJE

Nga Kompania OSHEE sh.a. që kërkon të kryejë Raportini e Vlerësimit të ndikimit në Mjedis të punimeve për punimet për investimin: "Ndërtim i rrjetit TM, me kabëll ABC në zonën Këneta e Durrësit, Shoqeria KULD sh.p.k. me qendër në Lezhë mori përsipër të kryejë këtë Raport, në mbështetje të një aktiviteti të qëndrueshëm dhe afat gjatë në mjedis, të zonës ku do të ndertohej rrjeti TU me kabell ABC në zonën Keneta e Durresit.

Qëllimi i studimit është të japë:

- një analizë sa më reale, nga pikëpamja e ndikimit të ndertimit të punimeve për montimin e shtyllave dhe rrjetit "TU me kabell ABC" mbi banoret dhe në mjedisin natyror;
- analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore;
- dhënien e masave zbutëse për minimizimin e ndikimeve negative;
- marrjen në konsideratë të vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit, gjatë aktivitetit,
- planin e menaxhimit dhe monitorimet për zërat përkatëse.

Metodologjia e përdorur

Për realizimin e studimit të VNM-së u kryen:

a. Vrojtme në terren në rajon të gjerë, duke kryer vrojtme pedologjike, gjeomorfologjike, ekologjike, si edhe hidrologjike, të shumëllojshmërisë së gjallesave, si dhe të përdorimit të tokës. Gjatë vrojtmeve në terren, kujdes i'u kushtua situatës për rreziqet natyrore rreth zonës në studim. Për të realizuar objektivat e këtij studimi janë marë:

- foto në territorin në studim;
- takime me ekspertët lokal dhe komunitetin e zonës;
- takime me specialistë të filialit të OSHEE -Durrës;

b. Argumentimi i bazuar mbi vlerësimin e:

- Studimi dhe skema e zhvillimit teknologjik;;
- inventaret e të dhënat ekzistuese;
- informacionet bazë, në botimet periodike mbi këtë zonë;
- Pajtueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, shkarkimet ujore, niveli i zhurmave dhe mbetjet e thata.

c. Vlerësimin me metodën e listë-kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër bartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit. Madhësia e ndikimit është shprehur me sistem prej 5 shkallësh (+) dhe (-).

). Burimet kryesore, për funksionimin e kësaj qendre janë:

- Mbajtja pastër e mjedisit përreth dhe në standarde të kënaqshme, pa shkaktuar mbetje ose ndotje, për të ruajtur kushtet ekologjike të zonës;
- përdorimi i rrjetave për izolimin e pluhurave dhe shmangien e aksidenteve;
- sperkatjen me ujë gjatë punimeve të gërmimit;
- Mbrojtja e kushteve ekologjike sipas standarteve;

Vlerësimi i situatës

Për të ngritur një infrastrukturë miqësore me mjedisin, sikundër dhe rajoni e ka në ADN e vet, kërkohet të merren në konsideratë disiplina e fusha si;

- Pozicionin gjeografik i objektit dhe kufijtë e tij;
- Relievi i azhornuar, të dhëna gjeologjike dhe gjeomorfologjike;
- Plani rregullues egzistues, realizimet dhe mosrealizimet, si dhe identifikimi i nevojave;
- Të dhëna hidro-gjeologjike, të dhëna klimatike dhe hidrologjike;
- Të dhëna mbi komunitetet bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës në studim;
- Raporti i ndikimit në mjedis;
- Kushtet sizmike e tektonike të rajonit;
- Burimet territoriale dhe ekonomike;
- Popullsia (gjëndja ekzistuese dhe tendecat e ndryshimeve);
- Të dhëna mbi infrastrukturën sociale dhe Arsimi;

I. RAPORT TEKNIK I PROJEKTIT

1.1 QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi: Të sigurojmë informimin për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për rrezikshmërinë e rezatimit të fushës elektro-magnetike të linjave të transmetimit të energjisë elektrike. Qëllimi afatgjatë është reduktimi i rrezikut të rezatimit të fushës elektro-magnetike të linjave të transmetimit të energjisë elektrike duke i vendosur tabelat treguese të rrezikut pranë shtyllave për të mos lejuar praninë e banoreve duke shmangur aksidentet e rrezikshme të kërcënimit të jetës së këtyre banorëve. Ky raport vlerësimi ka për qëllim përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit pas ndikimit në mjedis nga kryerja e punimeve të montimit të rrjetit elektrik TU20/0.4kV. Montimi i shtyllave dhe ndërtimi i rrjetit TU20/0.4kV me kabëll ABC ndërmerret si një iniciativë, që do të tentojë në:

1. Shfrytëzimin dhe përdorimin e energjisë elektrike në vend.
2. Përmirësimin e sistemit të transmetimit në nivelet lokale.
3. Sistemimin e rrjetit ekzistues TU 20/ 0.4 kV sipas standarteve dhe parametrave bashkekohor;
4. Rritjen e nivelit të tensionit në konsumator;
5. Sigurimin e vazhdueshmerisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve.
6. Sistemimi i abonentëve me adresa të sakta dega teknike- sistemi billing;
7. Eliminimi i mundësisë së abuzimit me energjinë elektrike të abonentëve keqdashës në keto zona që janë dhe pak larg, qendres e vezhgimit nga punonjësit e kompanisë;
8. Zbatimi i rregullores së sigurimit teknik.
9. Ruajtjen e vlerave ekologjike të peizazhit;
10. Rritjen e punësimeve në këto zona.
11. Kompesimet në komunitetin e zonës.

Si rezultat i këtij projekt zbatimi në keto kabina do të kemi keto impakte pozitive:

- Regullojmë dhe sistemojmë rrjetin ekzistues TU 0.4 kV sipas standarteve dhe parametrave bashkekohor.
- Rritim nivelin e tensionit në konsumatorët dhe sigurojmë vazhdueshmerinë e furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve.
- Regullojmë dhe sistemojmë abonentet me adresa të sakta dega teknike- sistemi billing.
- Eleminojmë dhe heqim perfundimisht mundësinë e abuzimit me energjinë elektrike të abonentëve keqdashës në keto zona që janë larg qendres e vezhgimit nga punonjësit e kompanisë.
- Duke qene zonë turistike regullojmë dhe sistemojmë dhe pamjen e rrjetit si dhe të qytetit nga moria e lidhje amatore apo individuale të abonentëve.

1.2. PREZANTIMI I PROJEKTIT

OSHEE- Durrës do të mirëpresë, ndihmojë dhe lehtësojë çdo iniciativë vëzhguese mjedisore, që do t'i këshillohet në "Lejen Mjedisore", në shërbim të së cilës është kryer edhe ky raport.

Gjithashtu, inspektimet nga specialistët e autorizuar të shëndetit publik dhe mjedisit do të mbështeten në çdo kohë për realizimin e auditimeve mjedisore dhe shëndetësore. Problem në zonën e Kënetës së Durrësit me furnizim të konsumatoreve me energji elektrike dhe për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike të kësaj zone është hartuar projekti i ndërtimit të rrjetit shpërndarës TU me përcjellesa ABC me vetëmbajtje të kabinës "BOX 135" ekzistues, fideri NR. 2, N/ST Spitalle". Shtyllat e reja do të lidhen në rrjetin "TU" 20/0.4kV, dhe për instalimin e tyre do të gërmohen gropa drejtkëndore në përputhje me standartet e OSHEE sh.a.

1.3. PERSHKRIMI I PUNIMEVE TEKNIKE

1. Tek shtyllat e demtuara do të vendoset shtyllat e reja ku shtyllat të futen 1.7ml në toke. Bazamenti i saj 1ml nga fundi do të betonohet dhe pjesa tjetër do të mbushet me dhe e gure dhe do të ngjishet.
2. Të gjitha konstruksionet metalike në shtyllë do të lidhen me sistemin e tokezimit.
3. Sistemi i tokezimit do të realizohet me anen e 6 elektrodave të tokezimit 1.5 ml.
4. Zbritesi i tokezimit do realizohet me hekur St/Zn \varnothing 12mm, dhe do lidhet me impiantin e tokezimit me shkeputes për realizimin e matjes së rezistencës së tokezimit.
5. Rezistenca e tokezimit të shtylleve për çdo periudhë të vitit duhet të jetë $<$ se 2Ω .
6. Të gjitha konstruksionet metalike do lyhen fillimisht me një dorë boje kundër ndryshkut dhe pastaj me dy duar boje vaji ose nitro.
7. Në shtylle dhe në kuadrin e tensionit të ulet do vendosen tabelat e sigurimit teknik.

A. Të dhëna teknike të linjes dhe kabines

1. Pika e lidhjes do të jetë tek Kabina BOX "2/1" ekzistuese nga N/ST Spitalle 110/20 kV Keneta Durrës;
2. Shtyllat do jenë B/A 9 ml
3. Thellesia e nguljes së shtyllave do të jetë sa 1/6 h (lartësia e shtylles pra 1.5m)
4. Përcjellesi i linjës do të jetë AL -25mm²
5. Do të bëhet sistemimi i linjes "TU" ekzistuese dhe të bëhet lidhja me Linjat ajrore me përcjellsa të izoluar me vetëmbajtje ABC, shërbejnë për të furnizuar me energji elektrike abonente një dhe tre fazore nëpërmjet përcjellsave ABC me vetëmbajtje me izolim XLPE të fiksuar në shtylle me aksesoret perkates.
6. Do të bëhet tokezimi i perseritur sipas projektit.
7. Rezistenca e tokzimit të kabines e matur në periudhën e verës në kohë të thatë do jetë $R_{tok} < 2\Omega$ në të kundërt do të shtohen nr i elektrodave.

B. Rikonstruksioni i rrjetit TU me përcjellesa AL me vetëmbajtje


Problem në këtë zonë ngelet rrjeti i tensionit të ulet, i cili ka nevojë për përmirësime me qëllim përballimin e ngarkesave kryesisht gjatë sezonit të verës. Për këtë arsye për të përmirësuar furnizimin me energji të abonentëve është hartuar projekti i rikonstruksionit të rrjetit TU. Rikonstruksioni i rrjetit TU 20/0.4 kV me kabllo me vetëmbajtje tip "ABC" konsiston në zëvendësimin e rrjetit të vjetër me përcjellesa të çveshur dhe ndërtimin e rrjetit të ri me kabllo me vetëmbajtje tip "ABC". Ndërtimi i rrjetit TU është i domosdoshëm pasi ndërtimi i këtij rrjeti është



hallka e fundit për të berë sistemimin total të rrjetit të shperndarjes në këtë zonë për keto kabina. Për shkak të amortizimit të medha që ka aktualisht kjo zonë dhe për të normalizuar ngarkesen do të ndertohet dhe rrjeti TU me percjellesa me vetembajtje ABC për keto kabina shtyllore në pozicionin e ri.

C. Materialet që do të perdoren në ndertimin e rrjetit TU:

I – SHTYLLAT


Për ndertimin e rrjetit të ri ne pergjithesi janë perdorur shtyllat ekzistuese në ato raste kur kemi rrjet dhe shtylla të reja bac. Shtyllat e reja do të jene b/arme 9/6 m /kN ndermjeteset dhe 9/15 m/kN ato ankeroret apo kendoret. Gjatë implementimit të ketij investimi do të hiqen të gjitha shtyllat e drurit apo ato metalike të vendosura nga vetë banoret dhe do të zevendesohen me shtyllat e reja prej b/arme. Të gjitha shtyllat e reja që do të vendosen sipas standartit të OSHEE dhe fundet e tyre gjithashtu do të betonohen.





Shpjegime Teknike

Linjat ajrore me percjellsa të izoluar me vetembajtje ABC, sherbejne për të furnizuar me energji elektrike abonente nje dhe tre fazor e nepermjet percjellsave ABC me vetembajtje me izolim XLPE te fiksuar ne shtylle me aksesoret përkates. Për mbajtjen e kabllit perdoren tirantuesa ankerore, në shtyllat fundore ose ankerore dhe tirantues ndermjetes ne shtyllat ndermjetese. Tirantuesit fiksohen te aksesoret shtyllorë. Për rastin e kablllove të aluminit, në tirantuesin ankeror ose ndermjetes, fiksohet i gjithë kablli ose vetem percjellesi i neutrit në vartesi të llojit të tirantuesit të perdorur. Për kabllot e bakrit në tirantues fiksohet detyrimisht i gjithë kablli. Lidhja elektrike e percjellesave behet me nyje lidhese të izoluar. Ndermjet dy tirantuesve ankerore, që ndodhen në dy ane të ndryshme të së njejtës shtyllë, kablli ka forme të harkuar me gjatesi jo me të vogel se 80 cm, me qellim qe të lejoje vendosjen e nyjeve izoluese.



II- KABLLI ME VETMBAJTJE TIP "ABC"

Kablli që do të vendoset në keto rrjeta do të jete kabell tip XLPE me seksione nga 95mm² deri në 25 mm² i cili do të kapet në shtyllat bac nepermjet aksesore të veçante (qafore + titantues+

konektore) në qafat e shtyllave. Në menyre që linja të jete sipas standartit dhe estetike duhet që qaforja e linjes ku do të kapet kablli të vendoset 25cm poshtë majes së shtyllës. Seksioni i tij do të zgjidhet në vartesi të ngarkeses dhe gjatesise së daljes. Kalimi i kabllit nga një seksion tek tjetri behet vetem në shtylle nepermjet konektore bashkues të linjes. Gjatë shtrirjes së tij në shtylla kablli do të terhiqet mire me parango në menyre që frexha e tij të jete brenda parametrave.

III – AKSESORET E RRJETIT KABLOR

Aksesoret e rrjetit kabllor janë qaforet e shtyllave, tirantuesit e linjes dhe konektoret e linjes.

IV – KABLLI I ABONENTIT

Kablli i abonentit do të jete dy llojesh:


- A – PVC koaksial CU – 1/1- 6 mm² për abonentet monofaze
- B – PVC – CU (4x10)mm² per abonentet 3 fazor.

V – AKSESORET E KABLLIT TE ABONENTIT

Aksesoret e kabllit të abonentit (qafore abonentit+ tiranti + upa sy + teli i tirantimit i xinguar $\varnothing = 4$ mm² + fasheta lidhese plastike) kanë standartet bashkengjitur këtij projekti.

VI - TOKEZIMI I PERSERITUR

Tokezimi i perseritur i linjës së tensionit të ulet me kablllo tip ABC është parashikuar sipas rregullores në çdo 4 – 5 shtylla. Do të behet tokezimi i ri i perseritur me dy elektroda në menyre që të arrihet rezistenca $R_t \leq 10 \Omega$, nqs nuk arrihet rezistenca e tokezimit me e vogel se 10Ω të shtohet numri i elektrodave.



1.4. PËRSHKRIMI I VEND-NDODHJES

Kushtet fillestare të vendit

Ky seksion i VNM paraqet rezultatet e një vlerësimi të dimensioneve të zonës së studimit dhe përshkruan kushtet përkatëse fizike, biologjike dhe social-ekonomike, duke përfshirë edhe

ndonjë ndryshim para se të fillonte projekti. Vlerësimi merr në konsideratë aktivitetet aktuale të zhvillimit dhe ato të propozuara brenda zonës së projektit ose që nuk lidhen direkt me projektin. Zona në të cilën do të montohen shtyllat e reja dhe rrjeti TU20/0.4kV është një zonë suburbane, me karakter kryesisht rezidencial, dhe me aktivitete të tjera të shumëllojshme në shërbim dhe në ndihmë të njerëzve dhe banorëve aty pranë, si dhe me orjentim të zhvillimit të tregëtisë. Siç mund të lexohet në dokumentacionin e bashkangjitur, territori është lejuar të përdoret nga institucionet drejtuese lokale, dhe nuk ka probleme pronësie.



Përshkrimi i territorit, ku do të ndertohet rrjeti TU me kabell ABC

Problem në këtë zonë ngelet rrjeti i furnizimit me energji elektrike teje i amortizuar dhe rrjeti i tensionit të ulet, i cili ka nevojë për permiresime me qellim furnizimin me energji konsumatoreve të kësaj zone. Për kete arsye për të permiresuar furnizimin me energji të abonenteve është hartuar projekti i ndertimit të rrjetit TU me kabell ABC, si dhe rikonstruksionit të rrjetit TU të tyre. Objekti është parashikuar të instalohet në një gjatësi territori, ku përfshihen reliev i sheshtë, dhe kalon nëpër zona urbane rezidenciale tashmë të stabilizuara. Nga pikëpamja hidrografike, objekti kufizohet nga kanale ujorë. Ndertimi i rrjetit TU është i domosdoshem pasi ndertimi i ketij rrjeti është hallka e fundit për të bere sistemimin total të rrjetit të shperndarjes në kabinën BOX "2/1" ekzistuese nga N/ST SPITALLE 110/20 kV. Ndertimi i ketij rrjeti gjithashtu është siguri për suksesin e investimit pasi në rrjetin TU me perciellesa ABC minimizohet mundesia e lidhjeve të paligjeshme në rrjet.



1.5 INFORMACION PËR QËNDRAT E BANUARA

1.5.1. Pozita gjeografike

Durrësi është qendra e dytë më e madhe industriale dhe afërsia me kryeqytetin e Tiranës. Duke qenë një qendër kryesore dhe strategjike turistike ka sjellë një rritje të vazhdueshme të popullsisë së tij, e cila sot numëron mbi 200 000 banorë. Qyteti shtrihet ($41^{\circ}19'N$, $19^{\circ}27'E$) në një gadishull të vogël në brigjet e detit Adriatik dhe është themeluar në vitin 627 para Krishtit nga kolonizatorët e Korinthit dhe të Kërkirës (Korfuzi i sotëm), në zonën e një vendbanimi të lashtë të fisit Ilir të Taulantëve.



Figure 1: Parku në hyrje të Durrësit

Kjo histori dhe vendndodhje e qytetit është mjaft e favorshme për cilësinë e jetës së qytetarëve të tij por edhe të turistëve. Qyteti i Durrësit, zë një sipërfaqe prej 46.1 km² dhe një popullsi prej 208.026 banorë. Nga pikëpamja administrative, është organizuar në 6 njësi administrative, që tashmë

emërohen Rajone Administrative, të cilat kanë popullsi dhe sipërfaqe sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Rajoni Nr 1	Rajoni Nr 2	Rajoni Nr 3	Rajoni Nr 4	Rajoni Nr 5	Rajoni Nr 6
Sipërfaqja km2	2.98	1	0.6	10.32	15.8	15.4
Popullsia	28667	28737	27718	53890	34999	34015

Rigjenerimi urban i zonës së “Durrësit të Ri” (ish-Kënetës). “Durrësi i Ri” është një zonë rezidenciale me popullsi të re dinamike, një zonë që ka nevojë për rinovim urban. Gjatë 4 viteve të ardhshme, ky rinovim do të jetë i plotë. Me projektet për rehabilitimin e infrastrukturës, si: “Ndërtimi i Sistemit të Furnizimit me Ujë”, “Rehabilitimi i Sistemit të Kanaleve të vjetra” duke i kthyer ato në rrugë të mirfillta, kjo zonë e re e qytetit do të ndërthuret me pjesën tjetër të qytetit, duke u bërë pjesë me sistemin e infrastrukturës së tij.



Harta e qytetit të Durrësit ndare sipas njesive administrative

1.5.2. Kushtet klimatike

Klima e qytetit të Durrësit është tipike mesdhetare, pra me dimër të butë, të lagësht dhe verë të ngrohtë, me diell dhe mjaft të thatë. Muajt e verës janë përgjithësisht me diell, kushtet jashtëzakonisht të nxehta hasen rrallë në bregdet dhe zbuten nga flladet detare. Kushtet e dimrit në bregdet janë përgjithësisht të buta, por erërat e ftohta të rastit nga veriu dhe lindja mund të ulin temperaturat për pak ditë kur malet janë të mbuluara me dëborë. Kur një erë e ngrohtë me lagështirë –shiroka – fryn nga juglindja ose jugu, kushtet mund të jenë shtypëse. Shiroka paraprin kohën e lagësht dhe një kthim të temperaturave më të ulëta. Në zonat e ulëta dhe

malore ecuria vjetore e kushteve të motit është e ngjashme me ato të bregdetit, por stina e verës është më e freskët dhe me më pak lagështirë. Gjatë ditëve me mot të keq në vjeshtë dhe dimër, mund të ketë shira dhe dëborë të dendur. *Instituti i Hidrometeorologjisë së Akademisë së Shkencave Tiranë* përmes stacionit meteorologjik në zonën e Durrësit ka kryer monitorime të cilat pasqyrohen në tabelat e mëposhtme.

Temperatura mesatare vjetore	Temperatura mesatare vjeshtë-dimrit	Temperatura mesatare pranverë-verë	Temperatura minimale
1	6	24	-6

Temperatura më e lartë regjistrohet në periudhën e verës dhe më saktësisht në periudhën Korrik-Gusht ndërsa temperatura me e ulët në periudhën e dimrit gjatë muajve Dhjetor-Janar. Stina e verës shoqërohet me thatësira të zgjatura ndërsa pranvera dhe vjeshta me reshje të shumta. Sasia e reshjeve ndryshon sipas stinëve siç paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme.

Sasia vjetore e reshjeve	Sasia e reshjeve verë	Sasia e reshjeve vjeshtë	Sasia e reshjeve dimër	Sasia e reshjeve pranve
836	26	326	363	1

Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mesatare vjetore
Bashkia Durrës	4,2	4,5	4,2	4,1	3,6	3,4	3,3	3,2	3,3	3,6	4,2	4,4	3,833

⁵ Instituti hidrometeorologjik ⁶ AKBN Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore




Figura 2: Trëndafili vjetor i erës për Durrësin (Q=7,6%; Shpejtësia= 3,8m/s)

1.5.3. Shërbimi arsimor

Gjatë 20 viteve të fundit Bashkia e Durrësit i ka dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi sektorit të arsimit si një mënyrë për të përmirësuar kushtet sociale dhe ekonomike të jetesës së njerëzve. Gjatë viteve „90 Durrësi varej nga Tirana për shkolla të mesme dhe universitete. Lufta për

autonomi në fushën e arsimit mori fund në vitin 2006 kur u inaugurua Universiteti A. Moisiu. Sot ky universitet ka një gamë të gjerë kursesh e fakultetesh. Më poshtë jepet lista e plotë e të gjitha institucioneve të arsimit në Durrës:

- 3 çerdhe publike me 150 fëmijë;
- 20 kopshte publike me 2 017 fëmijë;
- 8 kopshte jo publike me 254 fëmijë
- 22 shkolla publike 9-vjeçare me 16 191 nxënës;
- 9 shkolla jo publike 9-vjeçare me 1 453 nxënës;
- 8 shkolla të mesme publike me 6 823 nxënës;
- 7 shkolla të mesme jo publike me 1 161 nxënës;
- 1 shkollë e mesme profesionale me 678 nxënës;
- 1 universitet publik me 2 29 studente;

1.5.4. Infrastruktura

Zhvillimi i infrastrukturës së këtij qyteti synon në mbrojtjen e vlerave antike dhe historinë që mbart ky qytet duke projektuar një qytet të ri të zhveshur nga barrierat, duke synuar bashkimin e periferive të qytetit "Durrësi i Ri", si dhe kthimin e hapsirave të gjelbërta për çdo qytetar. Durrësi është qendra e sistemit hekurudhor shqiptar, si edhe porti më i rëndësishëm në vend dhe lidhet me Italinë me anë të trageteve të linjës Durrës – Bari, Durrës- Ankona, Durrës – Trieste. Lidhet me Slloveninë, me anë të tragetit të linjës Durrës – Kuper. Për më tepër Durrësi është edhe pikënisja e korridorit 8, si dhe kryqëzim i linjave më të rëndësishme të autorrugëve, sikurse është linja Durrës - Kukës – Morinë, e cila lidh Shqipërinë me Kosovën duke shkurtuar largësinë e udhëtimit. Durrësi është jo vetëm porti kryesor i Shqipërisë, por edhe një qytet - port i rëndësishëm ndërkombëtar në bregdetin Adriatik, duke ofruar akses për vendet e Ballkanit perëndimor në rajonin e Mesdheut. Durrësi ndodhet në fund të aksit metropolitan perëndimor Tiranë-Durrës, dhe lidhet me kryeqytetin nga një autostradë. Ai është gjithashtu lehtësisht i arritshëm nga qytetet e tjera të vendit me anë të një sistemi të mirë të transportit rrugor.

Sistemi rrugor ekzistues bashkiak

Shkalla e zhvillimit të ndërtimit të rrjetit rrugor është një nga treguesit kryesorë për gjendjen e zhvillimit të sistemeve të trafikut. Sipas shkallës së motorizimit dhe rritjes së përdorimit të autovegurave, e cila ka një tendencë gjithnjë në rritje, rrjeti rrugor në pjesën më të madhe të qyteteve shqiptare, nuk është në gjendje të përballojë këtë rritje të volumit të trafikut, pavarësisht masave drastike që janë marrë për të përmirësuar këtë situatë. Gjatësia e përgjithshme e arterieve të trafikut në qytet është e pakënaqshme në krahasim me popullatën dhe kërkesat e sajë për mobilitet. Sistemi i trafikut ekzistues ka vështirësi për efekt të gjendjes së keqe të sistemit të


rrugëve, kapacitetit të pamjaftueshëm të tyre, mos ekzistencës të të dhënave të trafikut, sistemet e këqija të transportit publik dhe mungesat për sheshe parkimi. Rritja e volumit të trafikut është shkak kryesor i rritjes së nivelit të ndotjes së ajrit, i cili shkakton një sërë problemesh social-ekonomike në qytet. Lëvizshmëria është një pjesë vitale e sistemeve të transportit për qytetin.

1.5.5. Kushtet dhe gjendja e Tokës

Kushtet e tokës në Durrës janë të lidhura ngushtë me të kaluarën e këtij qytetit si një qendër industriale ku dalloheshin ajo e plastikave, duhanit, kimikateve të ndryshme etj. Sigurisht që toka si një habitat dhe një ambient i pasur me gjene, shërben si një platformë për aktivitet njerëzor, për peizazhin dhe trashëgiminë, si dhe me një rol parësor në sigurimin e lëndës së parë. Këto funksione janë me një vlerë të madhe për mbrojtjen social-ekonomike sikurse dhe për mjedisin. Degradimi i tokës sjell efekte mjaft negative në shëndetin e popullatës, në ekosistemet natyrore, në shndërrimet e klimës si dhe ekonomi. Toka, që shërben si një ndërmjetës midis ujit, dheut dhe ajrit është një burim i parinovueshëm dhe që luan shumë funksione jetësore si p.sh në lidhje me ushqimin dhe prodhimin e biomasës, filtrimin depozitimin e mjaft substancave ndër të tjera edhe ujin, filtrimin, transformimin e mjaft substancave ku përfshihet uji, karboni dhe azoti.

Toka në Durrës siç e përmendëm edhe më sipër ka karakteristika të ndryshme. Kemi tokë bujqësore, tokë ranore në bregun e detit si dhe tokën e zonave industriale dhe ish industriale. Toka bujqësore në pjesën më të madhe të saj shtrihet në zonën e ish-kënetës dhe në atë të Shkozetit dhe është nën kërcënimin e vazhdueshëm të ndërtimeve të cilat po ngrihen dita-ditës duke krijuar fshatra të reja atje. Presioni i ndërtimit për banim si dhe ai i ndërtimit të ndërrmarjeve të vogla është në rritje. Kjo do të vështirësojë krijimin e zonës buferike të gjelbërt të planifikuar në zonat periferike përreth qytetit duke kërcënuar kështu standardet e jetesës së banorëve.

Toka ranishte shtrihet përgjatë bregut të plazhit të Durrësit dhe në Currila (pjesërisht shkëmbore) si dhe në atë të Porto Romanos. Kjo tokë është po ashtu e kërcënuar nga ndërtimet por edhe nga fenomeni i erozionit. Zonat industriale dhe ato ish-industriale në qytetin e Durrësit krijojnë një presion të madh mbi tokën si nga pikëpamja e sipërfaqes po ashtu edhe nga pikëpamja e ndotjes.



Bujqësia

Mbjelljet kufizohen në shërbime oboresh, si dhe parcelash apo ngastra, sipas përkatësisë së pronës private. Bujqësia është e zhvilluar disi mirë, duke kultivuar drithërat dhe bimët foragjerë. Vitet e fundit, disa fermerë kanë rifilluar kultivimin e vreshtarisë dhe të serave me perime. Bujqësia mbështetet kryesisht edhe në blegtorinë. Thuajse çdo familje rrit pula, ku në të shumtën e rasteve përdoren për prodhim vezësh apo vetkonsumim. Në Spitallë numërohen rreth 220 krerë lopë, 400 krerë dhenë dhe 3000 shpendë shtëpiake. Mjaft nga familjet merren edhe me kultivimin e bletarisë. Mjalti i prodhuar përdoret edhe për qëllime tregëtie. Përdorimi i tokës Komuna Spitallë, ka sipërfaqe toke bujqësore prej 2,700ha, e ndarë në 10 fshatra, e mbjellë me kultura bujqësore si më poshtë. Prodhimi bujqësor u zgjerua edhe sipërfaqja e punueshme e tokës që arriti në 15,000ha.

Blegtoria

Qyteti fitoi gjallërinë në vitet e monarkisë. Me investime italiane dhe vendase, Durrësi mori pamjen e një qyteti bashkëkohor. Mbas luftës së dytë botërore në qytet u vendosën marrdhëniet socialiste në prodhim, të cilat pavarësisht nga kufizimet e tyre, sollën transformime në jetën ekonomike të qytetit. Durrësi zinte vend parësor në jetën ekonomike të vendit. Gjatë 1945-1990, në qytet u bënë punime në rrjetin hidro-sanitar, u ngritën uzina e fabrika të industrisë së lehtë dhe ushqimore, mekanike, kimike, kantieri detar, objekte social-kulturore etj. Zhvillim mori transporti detar, hekurudhor, automobilistik. Në hyrje të qytetit u ngrit një lagje e re banimi. Kooperativat bujqësore të rrethit kultivonin grurë, misër, oriz, pambuk, perime, etj. Sistemi i ri dhe reformat ekonomike, që u zbatuan në Shqipëri dhe në Durrës pas '90 sollën ndryshime në jetën ekonomike.

Në Durrës, aktualisht janë në aktivitet mbi 4311 aktivitete ekonomike nga të cilat: 62 të huaja, 74 shoqëri të përbashkëta, (Filanto, Floryen, Eurotech, etj) që merren me rieksporimin e konfeksioneve, këpucëve, peshkut, etj.

1.5.6. Biodiversiteti, fauna dhe flora, pyjet dhe hapësirat e gjelbërta në qytet

a) Biodiversiteti, fauna dhe flora.

Durrësi karakterizohet nga biodiversiteti tipik i një zone mesdhetare. Habitatet shtrihen nga kodrat rreth qytetit, fushat dhe hapësirat e gjelbërta brenda qytetit, në bregdet si dhe në detin Adriatik.

Bimësia tokësore

Bimësinë në Bashkinë e Durrësit do ta ndanim në këto tipe kryesore: në atë të bimëve natyrore si dhe dekorative të mbjellura në mjedise te ndryshme. Këto të fundit do të karakterizoheshin nga bimësia e bregdetit dhe ajo që gjendet kryesisht në kodrat e qytetit (Vila e Zogut dhe Currilat) pa lënë pa përmendur këtu edhe drurët frutorë. Bimësia karakterizohet nga një larmi e lartë si rezultat i një ndryshueshmërie të lartë të kushteve ekologjike të krijuara nga kombinimi i llojeve të tokës, reshjeve dhe pozicionit topografik.

Tipet e bimësisë variojnë nga pylli, pemë qyteti dhe habitate shkurresh që janë tipike mesdhetare. Shpërndarja e aktuale e bimësisë dhe gjendja e habitateve pasqyrojnë veprimin e njeriut sot dhe në të shkuarën. Ndër llojet kryesore dhe më të përhapura të florës drusore mund të përmendim: Pishat bregdetare (*Pinus spp*), Shqopën (*Erica spp*), Dëllinjën (*Juniperus spp*) Gjineshrën (*Spartium junceum*), Plepat (*Populus spp*), Shelgun (*salix spp*), Selvinë (*Cupressus spp*), Trëndafilin e egër (*Rosa canina*). Ndërsa nga bimët dekorative që hasen më shumë në zonë janë: *Laurus nobilis*, *Mentha piperita*, bimë mjekësore si *Rosa canina* dhe ato frutore si *Citrus limon*, *Citrus sinensis*, *Olea europea*, mimozat ose *Acacia dealbata* (fam. *Fabaceae*), *Palmat* (fam. *Arecaceae*) etj. Në zona të caktuara dallohet edhe Ulliri (*Olea spp*) dhe shkurret e gjelbërta si: *Forsythia europa*, *Rubus fruticosus*. Shkurrja *Forsythia Europa* është një bimë endemike shqiptare. Flora barishtore nga ana e saj përfaqësohet më lloje të familjeve *Graminacea*, *Leguminacea* si dhe ato mjekësore nga të cilat mund të përmendim: *Festuca sp*, *Trifolium*, *Vicia spp*, *Urtica dioica*, *Sanguisorba officinalis*, *Salvia sp*, *Melisa officinalis*, Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), Bari i bletës (*Melisa officinalis*) Çikorja (*Cichorium intybus*). Bimësia e zonës më të ulët karakterizohet përgjithësisht nga prania e florës që normalist rritet në tokë moçalore të kripur, siç janë *Juncus acutus*, *Salicornia europea*, *Limonium vulgare*, *Hardeummarinum* dhe *Halimione portulacoides*, ndërsa toka me bar karakterizohet përgjithësisht nga *Dittrichia viscosa*, *Scalymus hispanicus*, *Pheniculavulgaris*, *Daucus carata*, *Eryngium spp.*, *Linaria spp.*, *Trifolium campestris*, *Avena sterilis*, *Hardeum murinum*, *Cynosurus echinatus*, *Achantus spp.*, *Pteridiumaquilinum*, *Rubus hulmifolius*.

Gjithashtu mund të përmendim edhe florën që gjendet në zonën ranore të bregdetit ku mund të përmendim bimësinë e dunave ranore si p.sh *Amophila arenaria*, *Stachys maritima*, *Panocratium maritimum* që konsiderohen edhe si lloje të rrezikuara, pasi edhe dunat ranore për shkak të erozionit detar janë dëmtuar shumë. Një punë e mirë është bërë në rrugën në hyrje të qytetit ku

janë mbjellur një numër i madhe pemësh me kurorë të gjerë dukë krijuar hije të mjaftueshme gjatët gjithë gjatësisë së saj, ndërkohë që parku në krah të saj dhe përballë shinave të trenit në dalje nga stacioni nuk ka mjaftueshëm hije për të garantuar qëndrimin e banorëve në të edhe gjatë ditëve më diell.

Fauna tokësore

Pakësimi i hapësirave të gjelbra dhe eliminimi gradual kryesisht i pishave në zonën e bregdetit por edhe në kodrat e qytetit ka bërë që të pakësohen habitatet për shpendët e për pasojë edhe shpendët. Shtimi i kurorave të gjelbërta do të ndihmonte shumë në ruajtjen dhe shtimin e fondit të shpendëve në zonë. Avifauna përfaqësohet nga zogj si; harabelat (fam. Passeridae), Korbi (fam. Corvidae), Gushkuqi evropian (fam. Muscicapidae), Gardalina, Carduelis carduelis (fam. Fringillidae); Pëllumbat, Columba palumbus dhe Columbia civia (fam. Columbidae). Nuk ka të dhëna për numrin dhe shpërndarjen e tyre. Pjesa e faunës tokësore përfaqësohet me kafshë si; Canis aureus (fam. Canidae), lepuri i egër, Oryctolagus cuniculus (fam. Leporidae) si dhe nga disa kafshë shtëpiake lopë, derra, dele, dhi etj. Gjithashtu gjenden edhe insekte si Grylotalpa grylotalpa, Agrotis segetum, Melolontha melolontha, Leptinotarsa decemlineata etj. Amfibët dhe zvarranikët janë të shumtë dhe mund të përmendim bretkocën Rana dalmatica, gjarprin Vipera ammodytes, zhapinjët Lacerta spp. etj. Disa nga kafshët e sipërpërmendura janë seriozisht të rrezikuara si pasojë e presioneve të mëdha të zhvillimit në zonat e sipërpërmendura. Toka është e pasur Limax maximus, Helix spp, Lumbricus spp, etj.

Biodiversiteti ujqor

Mjedisi ujqor në Bashkinë Durrës përbëhet nga deti Adriatik, dhe disa përrenj. Flora dhe fauna që zhvillohet në këto mjedise është e larmishme dhe ndihmon ekonominë e qytetit sidomos industrinë e peshkimit. Habitatet bregdetare dhe detare dallohen për shumëllojshmërinë e tyre sidomos në zonën e Currilave dhe më në veri, ku edhe dallohen katet si pasojë e natyrës së bregdetit. Në këtë zonë shfaqen bionozat me Posidonia oceanica. Livadhet me Posidonia, janë të rëndësishme pasi janë edhe një indikator i gjendjes mjedisore të ujit të detit duke qenë se është një bimë me ndjeshmëri ndaj dritës, e cila nga ana e saj depërton në thellësi (në varësi të kthjelltësisë së ujit të detit). Në rizomat dhe në fundet e mbuluara me Posidonia rriten alga si Sphaerococcus coronopifolius, Flabellia petiolata etj. Gjithashtu atje banojnë edhe molusqe si gastropodët Clanculus cruciatus, Clanculus corallinus, Tricolia tenuis etj. Aty rriten edhe disa briozoarë, hyfrozoarë etj. Livadhet me Posidonia oceanica, janë të rrezikuara si pasojë e ndotjes në zona të ndryshme të bregut sidomos në veri, ku lumi Erzen (në afërsi të Porto Romano), derdhet në breg.

Flora detare përbëhet gjithashtu nga Chlorophyta (algat e gjelbra), Phaeophytae (algat e murme, kafe) dhe që gjenden kryesisht në ato pjesë të detit ku ujë është më i ngrohtë dhe më pak i trazuar dhe që janë elementët kryesorë përbërës të fitoplanktonit. Në detin Adriatik, si dhe në zonën e Gjirit të Durrësit mund të gjenden specie të peshqve nga të cilët mund të përmendim: Arnoglossus laterna, Anguilla anguilla, Boops boops, Citharus linguatula, Dicentrarchus labrax, Deltentosteus quadrimaculatus, Dentex dentex, Diplodus annularis, Gobius niger jozo,

Lepidopus caudatus, Lepidotrigla cavillone, Lophius budegassa, Merluccius merluccius, Mugil spp., Mullus barbatus, Pagellus acarne, Pagellus erythrinus, Scorpoena notata, Serranus cabrilla, Serranus hepatus, Solea vulgaris, Sparus aurata, Spicara flexuosa, Trigla lucerna, Trigloporus lastoviza, Trisopterus minutus, Raja miraletus dhe specia e rrezikuar Raja asterias, (IUCN lista e kuqe). Gjithashtu në këtë hapësirë detare shihen edhe delfinë si dhe reptilë, ku mund të përmendim breshkat e detit si Caretta caretta dhe Chelonia mydas. Një pjesë e llojeve të përmendura më sipër bëjnë pjesë në listën e llojeve të rrezikuara janë përfshirë në librin e kuq.

1.5.7. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Menaxhimi i mbetjeve në Durrës vazhdon të mbetet një problem serioz si për shëndetin e popullatës, ashtu edhe për mjedisin në tërësi. Venddepozitimi i mbetjeve në zonën e ish kënetës është i mbushur mbi kapacitetin e tij dhe nuk ndodhet në pozicionin e përshtatshëm. Ky venddepozitim është i vendosur në një distancë shumë të afërt me disa zona informale të zhvilluara përreth kësaj zone. Totali i mbetjeve në bashkinë Durrës për vitin 2007 arriti në rreth 85000 ton.



Figura : Pamje e venddepozitimit të mbetjeve, Durrës

1.5.8. Cilësia e ajrit dhe ndotja në qytetin e Durrësit

Bashkia Durrës është mjaft e populluar, me një numër të madh automjesh, me një industri të zhvilluar dhe me portin më të madh detar të vendit. Sigurisht të gjithë këta së bashku përbëjnë dhe ndotësit kryesorë të ajrit në Bashkinë Durrës. Emetimet e tyre kryesore dhe të monitoruara janë dioksidi i squfurit, oksidi i azotit, grimcat e pluhurit (PM₁₀), PM_{2,5}, plumbi, O₃ si dhe komponentët organikë të avullueshëm VOC (Volatile Organic Components). Burimi i këtyre ndotësve janë industritë, veprimtaria ndërtuese, cilësia jo e mirë e karburanteve, gjendja jo e mirë e rrugëve automobilistike në disa zona të Bashkisë, por edhe pasojë e një trafiku të rënduar dhe me automjete të vjetra. Të dhënat zyrtare të cilësisë së ajrit në qendër të qytetit tregojnë se një pjesë e mirë e ndotësve janë brenda normave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare.⁷(tabelat 2.1.4 dhe 2.1.5).

Tabela 2.1.4-Monitorimi i ajrit dhe vlerat në qendër të qytetit Durrës (burimi ISHP)

Viti i monitorimit Ndotësit (µg/m ³)	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2011- 2012	Norma AL (µg/m ³)	Norma EU (µg/m ³)
PM ₁₀	92	95	93	93	100	116	121	51,1	60	50
O ₃	96	99	99	103	99	99	64	72	120	110
NO ₂	17	18	23	24	23	35	28	13,8	60	40
LPM	200	209	207	201	211	234	250	x	140	80
SO ₂	12	12	16	19	12	15	18	18	60	50
Pb	0,28	0,34	0,34	0,28	0,3	0,1	0,3	x	1	0,5

⁷ Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë

Në tabelën e mëposhtme jepen edhe disa ndotës të tjerë si dhe standardi kombëtar dhe ndërkombëtar. Me të kuqe janë shënuar ata ndotës të cilët i kalojnë vlerat e lejuara kombëtare apo ndërkombëtare.

Ndotësi (µg/m ³) Vlerat mesatare	CO	NO ₂	PM ₁₀	Benzene	Toluene	Ethylb	PM _{2,5}	O ₃	SO ₂
Durrës 2011-2012(mes)	0.443	13.8	51.1	1.2	3.36	0.61	30.02	17.44	1.97
Norma kombëtare	x	6	60	x	x	x	x	120	60
Norma KE	5	4	50	0,5	x	1	25	110	50

Ndotësit si plumbi janë të monitoruar. Niveli i përqendrimit të tij varet shumë nga cilësia jo e mirë e karburanteve që tregtohen në Shqipëri. Është logjike që sa më të reja të jenë automjetet aq më pak konsumojnë karburant dhe aq më mirë e djegin atë duke ndotur edhe më pak ajrin në raport me automjetet e vjetra. Nuk ka një numër të saktë të raportit midis automjeteve të reja e të vjetra por nga një vëzhgim i thjeshtë është e dukshme që pjesën më të madhe e përbëjnë automjetet e vjetra. Emetimet e dioksidit të karbonit janë të lidhura proporcionalisht me konsumin e karburantit, për 1% rritje (apo zbritje) të konsumit të karburantit kemi 1% rritje(apo zvogëlim) të sasisë së dioksidit të emetuar. Gjithashtu në Bashkinë Durrës kontribut në ndotjen e ajrit sjell edhe industria. Fabrika dhe punishtet e ndryshme duhen monitoruar për të zbatuar me rigorozitet emetimet dhe filtrat e përdorura nga ato në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin shqiptar.

Vendndodhja e vend-depozitimit të mbetjeve në zonën e ish kënetës, së cilës po i afrohen çdo ditë ndërtimet e ndryshme informale dhe ato me leje, përbën një tjetër burim ndotjeje për ajrin si dhe një tjetër kërcënim serioz për shëndetin e popullatës.

Një tjetër kontribuues është edhe rruga automobilistike kombëtare dhe trafiku i rënduar, e cila gjendet në një distancë të shkurtër nga qyteti dhe në varësi të drejtimit të erës mund të sjellë një rritje të ndotësve të ajrit në bashki.

Gjithashtu janë bërë edhe 663 monitorime në njësi të ndryshme prodhimi, shërbimi dhe rreth 51 monitorime në shkolla të ndryshme. Ndotja e ajrit për arsye të ndryshme rezulton më problematike në njësitë e prodhimit dhe shërbimit, por edhe në shkolla vërehet një rritje pranisë së CO₂ ndoshta si pasojë e numrit të lartë të nxënësve në një klasë.

Nisur nga monitorimet e rreth 7500 monitorime duket që cilësia e ajrit në këtë periudhë në Bashkinë Durrës duket të jetë problematike, si pasojë e rritjes së grimcave PM.2.5 dhe PM10, që vjen si rezultat i rritjes së vëllimit të ndërtimeve, ngritja e pluhurit, lëvizja e automjeteve, në vende të caktuara, cilësia jo e mirë e rrugëve, shtimi i numrit të industrive, shpesh edhe nga cilësia e keqe e karburanteve apo edhe nga djegia e mbeturinave në kontenierët në qytet, por edhe nga djegia e tyre në zonën e vendgrumbullimit të mbetjeve. Të gjithë këta faktorë si edhe shtimi i industrive përbëjnë një kërcënim serioz për të ardhmen e cilësisë së ajrit në Durrës. Duhet të merren masat e duhura për uljen apo eliminim dhe sjelljen e vlerave të tyre në normat kombëtare dhe ato të BE-së.

1.5.9. Monumentet kryesore ne qytetin e durrësit

Amfiteatri romak, Durrës

Amfiteatri i Durrësit është shpallur Monument Kulture ne vitin 1973, me shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës nr.1886, dt.10.06.1973. Amfiteatri i Durrësit, më i madhi dhe me i rëndësishmi, jo vetëm ne Shqipëri, por edhe në Ballkan, është ndërtuar ne fillim të shek të I-rë të e.s. Ai ka vlera të veçanta arkitekturore dhe artistike dhe, mund te krahasohet me monumentet e kësaj periudhe të Pompeit dhe Kapuas ne Itali. Amfiteatri ka trajtë eklipsi me diametër 136 metra dhe lartësi rreth 20 m. Amfiteatri romak i Durrësit është ndërtuar në faqen lindore të kodrës me kuotë 59 m, në pjesën juglindore të kështjellës, në mes të harkut verior dhe jugperëndimor të mureve të saj.

Gërmimet arkeologjike të bëra rrëze mureve të kështjellës kanë nxjerrë në dritë rrënojat e një amfiteatri të madh, i vetmi i këtij lloji në Shqipëri dhe ndër më të mëdhenjtë në botën antike. Deri tani është zbuluar vetëm gjysma e monumentit që përfaqësohet nga shkallarja, galeritë dhe dy menianume. Amfiteatri është ndërtuar me murature të përzier ose vetëm me tulla. Boshti i gjatë është vetëm 120 m. Boshti i gjatë është 120 m, boshti i shkurtër 101 m dhe boshti i arenës 61x42 m. Mendohet që kapaciteti i amfiteatrit të ketë qenë 1500 spektatorë. Në një mbishkrim latin i gjetur në qytet lexohet se me rastin e përrurimit të bibliotekës së Dyrrahut, në kohën e perandorit Trajan (91-117 m pas Krishtit) në amfiteatër u ndeshen 12 çifte gladiatorësh.

1.5.10. Kërkesat Sociale

Duke pasur parasysh kushtet social- ekonomike në zonën e Ndertimit te rrjetit TU me kabell ABC, ky rajon do të ketë përfitime nga montimi i shtyllave dhe rrjetit "TU" 20/0.4kV sepse regullohet dhe sistemohet rrjeti ekzistues TU 0.4 kV sipas standarteve dhe parametrave bashkekohor, si dhe rritet niveli i tensionit në konsumator dhe sigurojme vazhdueshmerine e

furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve.
Nuk pritet që montimi të shkaktojë një fluks të veçantë njerëzish të ardhur nga zonat e tjera. Kështu, nga ky këndvështrim, ndikimi në infrastrukturën e zonës do të ishte minimal. Gjatë periudhës së montimit të rrjetit TU me kabell ABC dhe shtyllave të reja do të jenë të nevojshëm 4 grupe punëtorësh me nga 6 veta.



1.6. SKICAT DHE PLANIMETRITË E OBJEKTEVE


Baza materiale për kabinën dhe Rrjetin TU me percjellesa ABC me vetembajtje ne kabinen BOX "2/1" ekzistuese nga N/ST Spitalle 110/20 kV ne zonen e Kenetes se Durrësit është si më poshtë:

NR	BAZA MATERIALE KABINA	NJESIA	SASIA
1	PERCELS ALÇ-25 mm ²	m	8700
2	TARVER "TM" MODEL "Y"	cope	50
3	IZOLATOR "TM" 10KV	cope	150
4	TRAVERSE "TM" E DREJT PER PIKE LIDHJE	cope	1
5	PERCJELLES ABC AL- 4x35 mm ²	m	250
6	PERCJELLES ABC AL- 4x25 mm ²	m	100
7	PERCIELLS ABC AL-4x16 mm ²	m	0
8	SHTYLLA B/A(8 ml) TE REJA	cope	0
9	SHTYLLA B/A (9 ml) TE REJA	cope	59
10	TRAVERSE MODEL "TU" 4-IZOLATOR	cope	0
11	ELEKTRODA TOKEZIMI	cope	20
12	KABELL KOAKSIAL 2x6 mm ²	m	450


Punimet për instalimin e kabinës janë:

- pas perfundimit të germimit të gropes, toka do të ngjeshet;
- mbushja e dyshemesë së gropës me një shtresë zhavori me h = 1.5m.;
- në tokat ujembajtëse do të ndertohet sistem drenazhimi perreth gropës;
- do të zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytezimit teknik;

Rrjeti TU me percjellësa ABC me vetembajtje në kabinën BOX "2/1" ekzistuese nga N/ST Spitalle 110/20 kV



RRJETI TU ME PERCJELLESA ABC ME VETEMBAJTJE NE KABINEN BOX "K-F.MUKA" EKZISTUESE NGA N/ST SPITALLE 110/20 KV KENETA DURRES



NR	BAZA MATERIALE KABINA "K-F.MUKA"	NJESIA	SASIA
1	KABELL XLPE AL 4 X 95 mm ²	ml	40
2	PERCJELLES ABC AL- 4X95 mm ²	ml	817
3	PERCJELLES ABC AL- 4X70 mm ²	ml	522
4	PERCJELLES ABC AL- 4X50 mm ²	ml	-
5	PERCJELLES ABC AL- 4X35 mm ²	ml	1069
6	PERCJELLES ABC AL- 4X25 mm ²	ml	-
7	SHTYLLA B/A 9/6(ml/ kN)/TE REJA	cope	4
8	SHTYLLA B/A 9/15(ml/ kN)/TE REJA	cope	6
9	ELEKTRODA TOKEZIMI	cope	22
10	PANEL TU (1x630+4x160A)	cope	1


Rrjeti TU me percjellesa ABC me vetembajtje në kabinën BOX "XH. Gjoni" ekzistuese nga N/ST Spitalle



NR	BAZA MATERIALE KABINA "K-145"	NJESIA	SASIA
1	KABELL XLPE AL 4 X 95 mm ²	ml	60
2	PERCJELLES ABC AL- 4X95 mm ²	ml	469
3	PERCJELLES ABC AL- 4X70 mm ²	ml	292
4	PERCJELLES ABC AL- 4X50 mm ²	ml	-
5	PERCJELLES ABC AL- 4X35 mm ²	ml	501
6	PERCJELLES ABC AL- 4X25 mm ²	ml	-
7	SHTYLLA B/A 9/6 (m ² /kN)/TE REJA	copz	8
8	SHTYLLA B/A 9/5 (m ² /kN)/TE REJA	copz	5
9	ELEKTRODA TOKEZIMI	copz	14
10	PANEL TL (1x630+3x160A)	copz	1


KABINA 20 @ 4KV "142/2" EKZISTUESE, FIDERI 2, N/S SHITALLE

1. PËR PËRMBRIMIN E FURNIZIMIT ME ENERJDI ELEKTRIKE TË ZONËS KËNETA ËSHITË HARTUAR PROJEKTI KRUEKIT SHIËRNOARËS TU ME PËRCJELLESA ABC ME VEÇITËSIAJTE TË KABËLËS "BOX 142/2" EKZISTUES, FIDERI NR. 2, N/S SHITALLE".
2. DALJET E PARA IDOTË REALIZOHEN ME KABËLL XLPE AL 4 X 95 MM²
3. NE KABINE IDOTË VENDOSJET NE B T ME 4 AUTOMAT 160A
4. SHTYLLAT E REJADO TË VENDOSHEN B ARME 9/6 (ML/KN) DHE 9/15 (ML/KN)
5. SHTYLLAT 9/6 (ML/KN) IDOTË JENE SHTYLLA SIDERMEJTESE NDORSA SHTYLLAT 9/15 (ML/KN) IDOTË JENE SHTYLLAT ANKERORE KENOORE
6. MONTIMI SHTYLLAVË DËJË TË KRËJETË PAS STANDARTIT TË OSHEE TË PARAQITUR NE FLETEN E DETAJEVE
7. NE REJË KABINE IDOTË ZHVILLIMEN 4 DALJE B T ME POSHTE
8. DALJA 1 IDOTË TË FLANZIT ABQVENTET NG SHTYLLA NR 1 DËRË NE SHTYLLAN NR 17
9. DALJA 2 IDOTË TË FLANZIT ABQVENTET NG SHTYLLA NR 14 DËRË NE SHTYLLAN NR 14
10. DALJA 3 IDOTË TË FLANZIT ABQVENTET NG SHTYLLA NR 11 DËRË NE SHTYLLAN NR 11
11. DALJA 4 IDOTË TË FLANZIT ABQVENTET NG SHTYLLA NR 4 DËRË NE SHTYLLAN NR 4
12. TË REJËT TOKËZIMI PËRSERITUR NE SHTYLLAT KU ËSHITË REJA BËN SHI PËRKATES, SUPAS STANDARTIT TË OSHEE TË PARAQITUR NE FLETEN E DETAJEVE
13. TË ZBATOHEN ME RËGROZITËT KUSHTET TËNËNGJE TË MONTIMIT TË KABËLLIT ABC PAS STANDARTIT TË OSHEE TË PARAQITUR NE FLETEN E DETAJEVE
14. TË ZBATOHEN ME RËGROZITËT KUSHTET TËNËNGJE TË MONTIMIT TË KABËLLIT ABC NE SHTYLLA DHE ATOTË S'GURIMIT TËNËNGJE
15. TË MERRËN LEJËT NE INSTITUCIONET PËRKATESË
16. DEMONTIMET E BLOKUT BT (ME AUTOMATET TU) DHE KRUEKIT EGZISTUES TU PRONE E OSHEE (PAS TË DEMONTIMEN NGJ FIRMA ZBATUESË) TË KTHEHEN NE MAGAZHEN E DREKTORISE SE RAJONIT DURRES




NR	BAZA MATERIALE KABINA "K-142/2"	NJESIA	SASIA
1	KABELL XLPE AL 4 X 95 mm ²	ml	40
2	PERCJELLES ABC AL- 4X95 mm ²	ml	777
3	PERCJELLES ABC AL- 4X70 mm ²	ml	461
4	PERCJELLES ABC AL- 4X50 mm ²	ml	61
5	PERCJELLES ABC AL- 4X35 mm ²	ml	1359
6	PERCJELLES ABC AL- 4X25 mm ²	ml	-
7	SHTYLLA B/A 9/6(ml/ kN)/TE REJA	cope	15
8	SHTYLLA B/A 9/15(ml/ kN)/TE REJA	cope	10
9	ELEKTRODA TOKEZIMI	cope	24
10	PANEL TU (1x630+4x160A)	cope	1

Rrjeti TU me percjellesa ABC me vetembajtje ne kabinen BOX " 142 / 1" ekzistuese nga N/ST Spitalle




NR	BAZA MATERIALE KABINA "K-142/1"	NJESIA	SASIA
1	KABELL XLPE AL 3 X 95 mm ²	ml	60
2	PERCJELLES ABC AL- 4X95 mm ²	ml	371
3	PERCJELLES ABC AL- 4X70 mm ²	ml	415
4	PERCJELLES ABC AL- 4X50 mm ²	ml	95
5	PERCJELLES ABC AL- 4X35 mm ²	ml	837
6	PERCJELLES ABC AL- 4X25 mm ²	ml	-
7	SHTYLLA B/A 9/6(ml/ kN)/TE REJA	cope	10
8	SHTYLLA B/A 9/15(ml/ kN)/TE REJA	cope	8
9	ELEKTRODA TOKEZIMI	cope	18
	PANEL TU (1x630+3x160)	cope	1

Rrjeti TU me percjellesa ABC me vetembajtje ne kabinen BOX " 142 /3" ekzistuese nga N/ST Spitalle



NR	BAZA MATERIALE KABINA "K-142/3"	NJESIA	SASIA
1	KABELL XLPE AL 4 X 95 mm ²	ml	60
2	PERCJELLES ABC AL- 4X95 mm ²	ml	487
3	PERCJELLES ABC AL- 4X70 mm ²	ml	367
4	PERCJELLES ABC AL- 4X50 mm ²	ml	-
5	PERCJELLES ABC AL- 4X35 mm ²	ml	891
6	PERCJELLES ABC AL- 4X25 mm ²	ml	-
7	SHTYLLA B/A 9/6(ml/ kN)/TE REJA	cope	8
8	SHTYLLA B/A 9/15(ml/ kN)/TE REJA	cope	0
9	ELEKTRODA TOKEZIMI	cope	22
10	PANEL TU (1x630+3x160A)	cope	1

Rrjeti TU me percjellesa ABC me vetembajtje ne kabinen BOX "7/1" ekzistuese nga N/ST Spitalle




NR	BAZA MATERIALE KABINA "K-7/1"	NJESIA	SASIA
1	KABELL XLPE AL 4 X 95 mm ²	ml	60
2	PERCJELLES ABC AL- 4X95 mm ²	ml	1030
3	PERCJELLES ABC AL- 4X70 mm ²	ml	400
4	PERCJELLES ABC AL- 4X50 mm ²	ml	-
5	PERCJELLES ABC AL- 4X35 mm ²	ml	1226
6	PERCJELLES ABC AL- 4X25 mm ²	ml	-
7	SHTYLLA B/A 9/6(ml/ kN)/TE REJA	cope	41
8	SHTYLLA B/A 9/15(ml/ kN)/TE REJA	cope	19
9	ELEKTRODA TOKEZIMI	cope	32
	PANEL TU (1x630+3x160A)	cope	1

Rrjeti TU me percjellesa ABC me vetembajtje ne kabinen BOX "135" ekzistuese nga N/ST Spitalle



NR	BAZA MATERIALE KABINA "135"	NJESIA	SASIA
1	KABELL XLPE AL 4 X 95 mm ²	ml	40
2	PERCJELLES ABC AL- 4X95 mm ²	ml	600
3	PERCJELLES ABC AL- 4X70 mm ²	ml	452
4	PERCJELLES ABC AL- 4X50 mm ²	ml	
5	PERCJELLES ABC AL- 4X35 mm ²	ml	455
6	PERCJELLES ABC AL- 4X25 mm ²	ml	-
7	SHTYLLA B/A 9/6(ml/kN)/TE REJA	cope	24
8	SHTYLLA B/A 9/15(ml/kN)/TE REJA	cope	10
9	ELEKTRODA TOKEZIMI	cope	18
10	PANEL TU (1x630+4x160A)	cope	1

Rrjeti TU me percjellësa ABC me vetembajtje në kabina BOX "Hajdarasi" ekzistuese nga N/ST Spitalle



NR	BAZA MATERIALE KABINA "HAJDARASI"	NJESIA	SASIA
1	PERCJELLES ABC AL- 4X95 mm ²	m	180
2	ELEKTRODA TOKEZIMI	COPE	2

1.7 PËRSHKRIM I PROÇESEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE

Karakteristikat e objektit

Për permiresimin e furnizimit të energjisë elektrike të zonës Kënetë e Durrësit do të ndërtohet rrjeti TU me percjellësa ABC me vetembajtje te kabines „BOX2/1“ ekzistues, FIDERI NR. 2 N/ST Spitalle’. Do të instalohen shtyllat e reja me 4 dalje në tension të ulet 0.4 kV. Shtyllat do të vendosen në pozicionin e parashikuar sipas projektit. Detaje per funizimin e abonenteve nga linjat kablore te TU me percjelles ABC:

- Linjat ajrore me percjellësa te izoluar me vetembajtje ABC, sherbejne per te funizuar me energji

- elektrike abonente një dhe tre fazore nepermjet percjellsave ABC me vetembajtje me izolim XLPE te fiksuar ne shtylle me aksesoret perkates.
- Shtyllat e reja do të vendosen b/arme 9/6 (ml/kn) do të jenë shtylla ndermjetese dhe 9/15(ml/kn) do te jene shtyllat ankerore kendore.
- Per mbajtjen e kabllit do perdoren tirantuesa ankerore, ne shtyllat fundore ose ankerore dhe tirantues ndermjetes ne shtyllat ndermjetese. tirantuesit fiksohen te aksesoret shtyllore.
- Per rastin e kabllave te aluminit, ne tirantuesin ankeror ose ndermjetes, fiksohet i gjithe kablli ose vetem percjellsi i neutrit ne vartesi te lloit te tirantuesit te perdorur dhe per kabllot e bakrit ne tirantues do fiksohet detyrimisht i gjithe kablli.
- Aksesori shtyllor per abonentin montohet 20-25 cm me poshte se aksesori shtyllor.
- Lidhja elektrike e percjellesave do behet me nyje lidhese te izoluara.
- Ndermjet dy tirantuesve ankerore, qe ndodhen ne dy ane te ndryshme te shtylles, kablli do kete forme te harkuar me gjatesi jo me te vogel se 80 cm, me qellim qe te lejoje vendosjen e nyjeve izoluese, ne qofte se ne te njejten shtylle lidhen dy apo me shume abonente, duhet qe distanca ndermjet kabllave koaksiale qe ndodhen prane njeri tjetrit te mos jete me e vogel se 20 mm. gjithashtu duhet qe distanca ndermjet dy skajeve te brendeshme te nyjeve izoluese(distanca me e afert ndermjet dy nyjeve fqinje) te vendosura ne te njejten faze(apo ne neuter), te mos jete me e vogel se 50 mm.

Përgatitja e vendit

Për instalimin e shtyllave të reja do të germohet një gropë drejtkendore në perputhje me standartet e OSHEE. sh.a.

- pas perfundimit të germimit të gropes, toka do të ngjeshet;
- dyshemeja e gropes do të mbushet me një shtrese zhavori me $h = 1m.$;
- në tokat ujembajtese do të ndertohet një sistem drenazhimi perreth gropës;
- do të zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytezimit teknik;
- vendet ku kryehen punime, pas perfundimit të tyre do të kthehen në gjendjen e me pareshme

Heqja e ujit nga vendi

Do të jetë e nevojshme, që të hiqet uji nga gërmimet e themeleve gjatë hapjes së gropave, dhe uji prej tyre do të shkarkohet në kanale drenazhimi.

Shkarkimi i materialit nga gërmimet

Mund të jetë e nevojshme të shkarkohen disa materiale të tepërta nga vendi në një vendndodhje jashtë vendit.

Shpërndarja e materialeve

Shpërndarja e materialeve gjatë procesit të ndërtimit do të bëhet me kamion. Shpërndarjet do të përfshijnë makina pune të lehta, ekskavatorë dhe mbajtës materiale mbushëse. Kufiri i shpejtësisë dhe mbushja e gropave, sistemimi i shesheve të punës, së bashku me spërkatjen me ujë të ambientit do të përdoren për të minimizuar gjenerimin e pluhurit nga ky aktivitet, duke bërë të mundur hapjen dhe mbulimin brenda ditës dhe më shpejt.

Forca Punëtore

Projekti do të kërkojë 4 grupe punëtorësh me nga 6 person secili grup gjatë fazës së montimit dhe rikonstruksionit të shtyllave dhe rrjetit TU me kabell ABC.

1.8 INFORMACION PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME

1.8.1. Sistemi natyror gjeomorfologjik

Rajoni në fjalë bën pjesë në Fushën e Durrësit, si një ndër fushat më të rëndësishme të vendit tonë, e cila përfshin pjesën qendrore të Ultësirës Bregdetare. Fusha e Durrësit përbëhet nga depozitime deluvionale, aluvionale, kënetore, liqenore dhe bregore deltore. Ajo është kapur nga lëvizjet neotektonike diferencuese. Kurrizi kodrinor është kapur nga lëvizjet ngritëse, kurse pjesët lindore dhe perëndimore të saj nga lëvizjet ulëse, që ka çuar në trashësinë e madhe të depozitimeve të shkrifëta. Shtretërit e lumenjve që përshkojnë atë janë të cekët, shpesh më lart se fusha përreth dhe me shumë meandrimë. Prandaj ato vërshonin shpesh duke përmytur, kënetëzuar e moçalizuar tokat përreth. Duke qenë se zona jonë inkuadrohet nga pikëpamja fiziko-gjeografike, në fushën e Durrësit, ai dallohet nga pikëpamja gjeologjike për vlera shumë të vogla të treguesve morfometrike. Copëtimi horizontal është 5-10 km/km² dhe ai vertikal është 150m për km² dhe në fushën rreth sektorit tonë, ai shprehet akoma më lehtë. Relievi erozivo denudues, ndryshe nga zonat e tjera të kësaj fushe gjen zhvillim të vogël, për shkak të niveleve të ulta, ku proceset e erozionit lozin rol jo shumë të madh.

1.8.2. Sistemi sizmologjik

Bazuar në të dhënat sizmologjike Durrësi konsiderohet si qendra e tërmeteve në Shqipëri, pra Durrësi shtrihet në një zonë me sizmicitet të lartë e njohur si zona pranë ultësirës së Adriatikut, ku janë regjistruar tërmete si ato në tabelën e mëposhtme. Të dhënat e tabelës së mëposhtme janë bazuar në sizmicitetin historik të Durrësit ku dallojnë termet me intensitet të lartë dhe me rrezik për jetën e banorëve të Durrësit, gjë e cila duhet të kihet parasysh nga ana e autoriteteve të ndërtimit pasi mund të jetë me pasoja tragjike. Gjithashtu edhe të dhënat e sizmicitetit instrumental janë të tilla që përforcojnë faktin e rrezikut të lartë sizmik në rrethin e Durrësit duke përfshirë këtu edhe

Bashkinë. Përshpejtimi varion nga 0.2g në të gjitha territorin në 0.3-0.38g në pjesën jug dhe veri perëndimore të vendit. Në rast se harta e mësipërme do të merret në konsideratë si rregullore e re zonimi, kjo do të thotë që autoritetet përkatëse duhet të marrin në konsideratë rishikimin e kodit të ndërtimit në baza më reale dhe më një shkallë më të lartë se sa ajo e rregullores ekzistuese të ndërtimit. Rezultatet e tabelës së mëposhtme duhen të konsiderohen të besueshme por sidoqoftë duhen analizuar edhe më në thellësi.

Figure: Harta e shpërndarjes së epiqendrave të tërmetejeve në SHqipëri




Tabela 2.1.10-Sizmiciteti historik i zonës përreth Durrësit

Viti i tërmetit	Intensiteti në ballë	Shkalla	Zona e dëmtuar
58 pes	8,5	MSK-1964	Durrë
334	8,5	MSK-1964	Durrë
346	9	MSK-1964	Durrë
506	8,5	MSK-1964	Durrë
521	8	MSK-1964	Durrë
1273	9	MSK-1964	Durrë
1852	8	MSK-1964	Kepi Rodonit, Ishëm
1869	8	MSK-1964	Durrës, Ishëm
1870	8	MSK-1964	Durrës, Elbasan

Tabela 2.1.11-Sizmiciteti instrumental i zonës përreth Durrësit

Viti i tërmetit	Intensiteti në ballë	Shkalla	Zona e dëmtuar	Epiqendra
1926	9	MSK-1964	Durrës, Tiranë, Ishëm, etj.	Durrës

1934	6	MSK-1964	Durrës, Tiranë, Ishëm	Romanat
1935	5	MSK-1964	Durrës, Elbasan, Ishëm	Librazhd
1967	6	MSK-1964	Durrës, Dibër, Librazhd	Dibër
1970	6	MSK-1964	Tiranë, Durrës, Lushnjë	Baldushk
1979	7	MSK-1964	Shkodër, Durrës, Tiranë	Petrovac
1988	6	MSK-1964	Tiranë, Durrës	Tiranë

1.8.3. Dukuritë e lëngëzimit të rërave të vrojtuar nga tërmetet e së kaluarës

Në tabelë jepen dukuritë e lëngëzimit të rërave të vrojtuar në zonën bregdetare Durrës- Seman gjatë tërmeteve të së kaluarës (Sulstarova E., Koçiaj S., 1975)

Tërmete që kanë shkaktuar dukuri lëngëzimi

Tërmeti	M	Intensiteti në ballë	Vendi	Dukuritë e vrojtuar si pasojë e lëngëzimit të rërave
27.12.1926	6.0	8-9	Durrës-Shijak	Shatërvanë uji të ngrohtë, pseudovullkane uji të përzier me rërë dhe çarje në tokë.
01.09.1959	6.4	8-9	Brigjet e Semanit dhe Osumit	Çarje në truall në rrethin e Beratit (Çiflik dhe Pashalli) me gjatësi disa qindra metra, shatërvane uji dhe rëre. Dukuri të ngjashme në Ngurëz të Vogël të Lushnjës. Rrëzimi i brigjeve të Semanit tek ura e Kuçit dhe i brigjeve të Osumit në afërsi të Urës Vajgurore.
18.03.1962	6.0	8	Rërës Fier Novoselë (Vlorë)	Çarje me gjatësi 100m dhe gjerësi deri 40 cm. Shatërvane uji të përzier me rërë sipas çarjeve dhe gjatë shtratit të lumit të Gjanicës dhe Semanit.

Tërmetet maksimal të mundshëm

Për vlerësimin e rrezikut sizmik të pritshëm duhet të njohim vatrat e tërmeteve të fortë të pritshëm (duke përdorur të dhënat sizmologjike dhe sizmotektonike) si dhe energjinë maksimale që mund të çlirohet nga vatra të tilla (ose siç thuhet ndryshe tërmete maksimal të mundshëm (M_{max}) dhe efektet sipërfaqësore që ata mund të shkaktojnë qoftë përsa i përket tronditjeve të forta sipërfaqësore (të shprehura nëpërmjet intensitetit sizmik), qoftë përsa i përket dukurive që mund të indukojnë në sipërfaqe të Tokës, siç mund të jetë lëngëzimi i rërave. Vlerësimi i M_{max} konsiderohet nga shumë studiues si problemi kryesor i vlerësimin të rrezikut sizmik, dhe vlerat e M_{max} janë një ndër parametrat kryesor për vlerësimin e lëngëzimit të rërave. Për hir të mungesës së të dhënave historike afatgjata homogjene dhe mangësive që kanë katalogët e tërmeteve për periudha të mëdha vrojtimi, shumë studiues përdorin për këtë qëllim vetëm ngjarjet më të mëdha vjetore për vlerësimin e M_{max} . Duke u bazuar në teorinë e vlerave ekstremale (shpërndarjen e tretë të Gumbel-it) (Gumbel, 1958), si dhe të dhënat e aktivitetit sizmik të normalizuar në kohë dhe hapësirë, u përcaktuan vlerat e pritshme të M_{max} për sektorin Porto Romano-Durrës që jepen në tabelën më lart. Po në këtë tabelë jepen edhe vlerat e pritshme të nxitimeve maksimal të tokës, sipas relacionit të gjetur për zonën epiqëndrore të tërmetit të 15.4.1979 (Koçiaj S., 1982):

- $PGA (g) = 0.4263 \cdot M - 0.6822 \cdot \log r - 1.5047$ duke pranuar si vlera të largësisë hipoqëndrore

të zonës bregdetare nga vatrat e tërmeteve maksimal të mundshëm $r=10-50\text{km}$.

Tërmetet maksimal të mundshëm (M_{max}) për zonën Durrës dhe vlerat korespondues të nxitimeve maksimale të pritshëm (PGA) në (g)

Zona	Emërtimi	M_{max}	Vlerat e nxitimeve maksimale (PGA) në (g) për largësi të ndryshme hipogëndrore (R)				
			R=10km	R=20km	R=30km	R=40km	R=50km
1	Durrës-Golem	6.6	0.63	0.42	0.30	0.22	0.15
2	Kavajë	6.5	0.58	0.38	0.26	0.17	0.11
3	Divjakë	6.4	0.54	0.33	0.22	0.13	0.07
4	Seman	6.3	0.50	0.29	0.17	0.09	0.02

1.8.4. Kushtet gjeologjike


Zona e Durrësit përfshihet në zonën Jonike, e cila karakterizohet nga depozitime që përfshijnë një diapazon kohor nga Triasi deri në ditët e sotme. Pjesa qendrore dhe perëndimore e zonës jonike e përfaqësuar nga Ultësira Joniano- Adriatike, në të cilën përfshihet edhe zona e gjerë e Durrësit. Në zone Peri-Adriatike takohen disa kodra, të cilat përfaqësojnë struktura antiklinale dhe disa zona të rrafshta që përfaqësojnë struktura sinklinale. Ultësira ndërtohet nga depozitimet neogjenike, të cilat përfaqësohen nga shkëmbinj argjilore, alevrolite, konglomerate dhe ranore. Në zonën e studimit takohen dy struktura të rëndësishme gjeologjike: antiklinali i Durrësit dhe sinklanali i Spitallës të lidhur përkatësisht me kodrat dhe fushën e Durrësit. Një thyerje tektonike gjatësore aktive i ndan të dyja strukturat dhe është shkaktare e aktivitetit të lartë sizmik në këtë zonë. Kjo thyerje tektonike konsiderohet si një nga thyerjet më aktive shqiptare. Pozicioni i saktë i thyerjes tregohet në hartën gjeologjike. Antiklinali i Durrësit ndërtohet nga depozitimet e Miocenit dhe Pliocenit të cilët zhyten në lindje me kënde rreth 60° deri në 70° .

Depozitimet e Miocenit formohen nga mollasat Mesiniane (N13m) dhe takohen në sipërfaqe në pjesën perëndimore të kodrave të Durrësit, si dhe në kodrat e Bishtit të Pallës. Ato përbëhen nga argjila, alevrolite, ranore dhe gipse. Trashësia maksimale e tyre është rreth 3000 m. Sinklinali i Spitallës zhvillohet në zonën fushore të ish-kënetës së Durrësit. Pjesa e sipërme e sinklinalit ndërtohet nga depozitimet e Pliocenit ("Suita Helmesi") dhe depozitimet e Kuarternarit. Depozitimet e "Suites Helmesi" (N21h) përfaqësojnë pjesën e poshtme të depozitimeve të Pliocenit. Këto depozitime përbëjnë pjesën më të madhe të pjesës qendrore dhe lindore të kodrave të Durrësit dhe ndahen në tre horizonte: horizonti i poshtëm (N21ha), i përbërë nga ranore, konglomerate dhe argjile, horizonti i mesëm (N21hb) dhe horizonti i sipërm (N21hc) i

përbëre nga argjile me thjerrëza ranoresh. Trashësia maksimale e depozitimeve të "Suites Helmesi" është rreth 1200-1300m. Depozitimet e Kuaternarit, të përfaqësuar nga suargjila dhe surera me trashësi maksimale prej rreth 3m, mbulojnë shkëmbinjtë e vjetër të kodrave të Durrësit. Këto depozitime janë të gjenezave të ndryshme, si: depozitime aluviale, kënetore dhe depozitime detare. Trashësia maksimale e depozitimeve kuaternare në sinklinalin e Spitallës është rreth 130 m. Depozitimet aluviale (alQh) vendosen mbi depozitimet e "Suites Helmesi" dhe në pjesën më të madhe të Sinklinalit të Spitallës dhe arrijnë deri në thellësinë 50-60 m. Trashësia maksimale e depozitimeve zhavorore, rërore, surërore dhe suargjilore është rreth 70 m, ndërsa trashësia e shtresave të zhavorit varion nga 1-2 m deri në afërsisht 20m. Mbi depozitimet aluviale vendosen depozitimet kënetore të Holocenit (lQ4h2), të cilat dalin në fushën e Spitallës (ish Kënetë e Durrësit). Ato përfaqësohen kryesisht nga sedimente me kokërr imët si argjila, suargjila, rëra dhe lënde organike. Trashësia maksimale e tyre në qendër të ish-kënetës së Durrësit është rreth 50 m. Depozitimet detare të Holocenit (dQ4h2) takohen përgjatë Plazhit të Porto Romanos dhe Gjirit të Lalzit. Ato përbëhen nga depozitime rërore dhe argjilore-rërore, trashësia maksimale e të cilave është rreth 20 m. Këto depozitime mbulojnë gjithashtu të gjithë zonën e akuiferit në Bishtin e Pallës.

Depozitimet kënetore

Shtrihen në ish kënetën e Durrësit, sot fusha e kanalizuar – pjesa perëndimore e saj në nivelin e detit. Prerja sipërfaqore e këtyre depozitimeve përfaqësohet në pjesën e sipërme e deri në 0.8 m nga material argjilor shumë ngjyresh dhe me nuanca të errëta deri të zeza, plastike, me horizonte të holla të grumbullimeve të makrofaunave kryesisht të bivalvoreve në thellësi 0.10 m deri në 0.40m. Me poshtë deri në thellësinë 1.5 m përfaqësohet nga argjila me alternime të niveleve të horizonteve me makrofauna kryesisht bivalvor të ruajtura dhe detritike, në disa raste makro fosilet kanë shpërndarje të çrregullt. Prej 1.5 m deri 2 m vërohet një horizont, ku dominojnë copra makrofaunash dhe makrofauna bivalvoro si dhe perzjerje rere.



1.8.5. Kushtet hidrogeologjike

Nga pikëpamja hidrogeologjike, rajoni në studim bën pjesë në pellgun e madh artezian të Ultësirës Perëndimore, i cili është i pasur me ujra nëntokësore. Kjo është e kushtëzuar nga përhapja e shkëmbinjve me veti të mira dhe mesatare kolektore (zhavorre dhe konglomeratë), nga kushtet e favorshme klimatike me reshje rreth 1000 mm/vit, nga një rrjet i dendur hidrografik dhe me relief fushor me pjerrësi të vogël drejt perëndimit.

Ujërat nëntokësore

Zona e Durrësit është e pasur me ujëra të cekta nëntokësore. Për këtë arsye ato janë edhe lehtësisht të kërcënuara nga ndotja. Ujërat e cekta nëntokësore në zonën e Durrësit vijnë nga basenet e Ishmit dhe Erzenit. Këto ujëra kanë një përmbajtje të pH prej 7 deri 9 dhe janë të pijshëm. Këto ujëra rrezikojnë të ndoten nga prania në zonën e kënetës të vendgrumbullimit të mbetjeve, nga ndotja e mëparshme e mjedisit dhe tokës në zonën e lindanit dhe të bikromateve, nga ish fabrika e prodhimit të kimikateve me bazë sulfuri si dhe nga ekzistenca e një vend grumbullimi mbetjesh kimikatesh si pasojë e reshjeve të shumta.

- Burimet kryesore të ndotjes janë dhe mbetjet urbane (mbetje inerte dhe të lëngshme). Ndotja e ujit urban ndodh nga prania e P (fosforit) që e ka burimin nga detergjente të ndryshëm që përdoren kryesisht prej familjeve. Nitratat (Azotet) janë një tjetër element ndotës i gjendur në ujë, në formën e NO₂ dhe NO₃, që vjen prej aktiviteteve urbane, bujqësore dhe

industriale. Ndotja më e madhe e ujit është ndotja mikrobiologjike që shkaktohet nga ujërat e zeza dhe që përfundojnë pa trajtimin e tyre, në lumenj dhe në forma të tjera në anë të rrugëve dhe kanaletnatyrore të drenazhimit dhe përfundimisht derdhja e tyre në det.

Duke u bazuar në kriterin litologo-stratigrafik, veçohen dy komplekse kryesore ujëmbajtëse:

- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të shkriфта Kuaternare (Q₄);
- Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve molasike të përfaqësuara nga konglomeratët dhe ranorët e suitës Rrogozhina dhe ranorët e Miocenit të Sipërm.

Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të shkriфта Kuaternare

Ky kompleks ujëmbajtës përhapet në të gjithë rajonin e studiuar si në njësinë gjeomorfologjike bregdetare ashtu dhe në atë detare. Simbas ujë përshkueshmërisë dhe ujëmbajtjes, brenda këtij kompleksi dallojmë këto horizonte ujëmbajtëse:


- Horizonti ujëmbajtës i rërave bregdetare, me përshkueshmëri mesatare deri të vogël, me përhapje të gjerë në të gjithë brezin bregdetar me dune të zhvilluara, me ujëmbajtje në përgjithësi të vogël.
- Horizonti ujëmbajtës i rërave lagunore-kënetore me përhapje të kufizuar, me përshkueshmëri dhe ujëmbajtje të vogël.
- Horizonti ujëmbajtës i rërave dhe i surerave aluviale me përhapje në të gjithë njësinë fushore, me një përshkueshmëri mesatare deri të vogël dhe ujëmbajtje të vogël. Të tre horizontet e lartpërmendur kanë ujëra pa presion.
- Horizontet ujëmbajtëse me presion të zhavorrëve aluvialë me përshkueshmëri të lartë, përhapje të gjerë në të gjitha luginat lumore të rrjedhjes së poshtme dhe me ujëmbajtje të madhe.

Për qëllime ndërtimore, rëndësi marrin horizontet e ujërave pa presion, që përbëjnë për çdo shesh horizontin e parë ujëmbajtës nga sipërfaqja e tokës (horizonti i rërave detaro-lagunore ose aluviale), ndërsa për qëllime furnizimi me ujë të pijshëm të qyteteve, industrisë dhe vaditje, marrin ujrat nëntokësore të thella të konglomeratëve të suitës Rrogozhina.

Ujërat nëntokësore të rërave detare - lidhen me përhapjen e dunave që shtrihen pas brezit të plazheve me gjerësi 100-200m. Këto ujëra pothuajse mungojnë në rajonin tonë

Ujërat nëntokësore të rërave lagunore-kënetore - shtrihen gjatë gjithë brezit të lagunave dhe ish kënetave pas brezit të dunave, si në fushën e ish kënetës së Durrësit, etj. Rërat lagunore-kënetore kanë trashësi që luhet nga 5 deri 12m. Ato mbështeten mbi argjilat e kaltërta kënetore. Thellësia e shtrirjes së tyre gjatë periudhës së dimrit luhet nga 0.5m, në sektorët e ulët fushor, deri në 3m rreze kodrave që rrethojnë kënetat. Amplituda e lëkundjeve të nivelit të ujërave të rërave lagunore është 0.5 deri 1.5m. Sipas punimeve të zbulimit të kryera në ish kënetën e Durrësit, rërat karakterizohen me veti të ulta filtruese dhe me ujëmbajtje të dobët. Nga analizat kimike të ujit të rërave lagunore rezulton se ato janë të një cilësie të keqe higjieno-sanitare, nuk janë të pastra, kanë reaksion acid dhe si të tilla agresive ndaj materialeve të ndërtimit, dhe në përgjithësi në sektorët e ulët (në qendër të ish kënetës) kanë dhënë ujë të kripur me $Mp > 1gr/l$ të tipit hidraulik Cl-SO₄-Na-Mg.

Ujërat nëntokësore pa presion i rërave dhe surerave aluviale. Këto ujëra përbëjnë horizontin e parë ujëmbajtës nga sipërfaqja e tokës. Ky horizont shtrihet në të gjithë njësinë gjeomorfologjike fushore dhe karakterizohet me një përshkueshmëri të lartë, përhapje të gjerë dhe ujëmbajtje të madhe. Të gjithë lumenjtë e Ultësirës Perëndimore në rrjedhjen e poshtme të tyre në zhavorret e varrosura formojnë shtesa të fuqishme ujërash nëntokësore me presion me rëndësi të madhe praktike për furnizimin me ujë të pijshëm të qyteteve të Ultësirës Perëndimore (Dakoli H., Xhemalaj Xh., 1996). Zhavorret e varrosura ujëmbajtëse karakterizohen nga një lidhje e mirë hidraulike me lumenjtë, ç’ka kushtëzon ujëmbajtjen e lartë të tyre ashtu dhe mundësinë e rritjes së resurseve të shfrytëzimit me puse të shpuar pranë brigjeve lumore nëpërmjet infiltrimit të nxitur të ujit nga lumi.



Uji i pijshëm

Durrësi furnizohet dhe nxjerr ujë të pijshëm nga burimet ujore të Fushë Kuqes. Një pjesë e madhe e sistemit ekzistues ka qenë rinovuar dhe uji i burimit është higjenikisht i sigurt. Kjo bën që uji i pijshëm që vjen në rubinete të jetë i sigurtë. Përveç mangësive të infrastrukturës, edhe kapaciteti i burimeve të ujit (Fushë Kuqe dhe Fushë Kruja) është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat aktuale. E ndikuar nga faktorët që përmendëm me sipër kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë është nga 1 në 2 orë në ditë gjatë sezonit të pikut në verë. Standardet evropiane për konsumin e Ujit të Pijshëm(Direktiva)11 janë 200 litra për banorë, pra teorikisht kjo shifër nuk mund të konsiderohet aspak e mjaftueshme sidomos po të kemi parasysh këtu që veç popullsisë rezidente shtohen edhe rreth 25000 turistë në ditë ku nevojat për ujë të tyre janë të mëdha. Humbjet në rrjetin e ujit të pijshëm si rezultat i shpërndarjes, i ndërhyrjeve etj në rrjet është afërsisht 15%.

II. RAPORTI PARAPRAK

I VNM-së

2.1. NATYRA E VNM

VNM-ja përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social. VNM është një proces, që zhvillohet brenda procesit të planifikimit dhe zbatimit të projektit për të përmirësuar cilësinë e planifikimit të projektit në kushtet e një zhvillimi të qëndrueshëm. VNM është një mjet, që i tregon vendim-marrësve dhe publikut pasojat ambientale të projekteve, në mënyrë që ato të mund të modifikohen, me qëllim që të evitohen dëmtimet e mjedisit, gabimet në ndërtim dhe humbjet ekonomike, që vijnë nga efektet negative direkt ose indirekte. Në procesin e VNM, përdoret informacioni dhe të dhëna ekzistuese, si edhe ato të përfituara rishtazi mbi kushtet e montimit të shtyllave, Ndërtimin e rrjetit TU me kabell ABC dhe rikonstruksionit të rrjetit "TU", së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar ndikimet potenciale mjedisore dhe sociale të lehtësirave të propozuara.

2.2. PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis bazohet në Legjislacionin Shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis siguron një përmbledhje të informacionit të disponueshëm në përputhje me kushtet e vend-ndodhjes së veprës, duke përfshirë kushtet fizike dhe atmosferike, burimet ujorë dhe biologjike, kulturën dhe kushtet social-ekonomike të zonës.

Metoda e përshtatshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis është ajo e list-kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundëshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër bartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit. Madhësia e ndikimit është shprehur me një sistem prej 5 shkallësh (+) dhe (-). Në këtë studim jepen në detaje:

- Mundësitë për teknologji të pastër;
- Kritje dhe zhvillim të qëndrueshëm;
- Shqyrtimi i alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Vlerësimi cilësor me pike të ndikimeve në mjedis të projektit.

- Propozimeve të masave zbutëse të ndikimit të projektit.

Ndotja e ajrit nga ky aktiviteti përfshin kryesisht atë të zonës brenda saj, të cilat emetohen në sasi të papërfillshme. Ndotja e ajrit do të jetë në nivele të kontrolluara.

2.3. QËLLIMI I VNM

Qëllimi i VNM, është që nëpërmjet vlerësimit cilësor e sasior paraprak të parametrave ekologjik, të treguesve morfologjik e gjeomorfologjik, hidrogeologjikë e hidrologjikë, të kushteve gjeologjiko-inxhinierike (vetitë fiziko-mekanike), parametrave sizmo-tektonik, të bazuara në kriteret standarte shkencore ndërkombëtare, sipas Konventave Ndërkombëtare e Kombëtare, të tipizohen dhe të përzgjidhen një sërë parametrash dhe veçorish të sistemeve natyrore, në shërbim të menaxhimit të infrastrukturës mjedisore, të mbrojtjes së aksidenteve, të përmirësimit të kushteve të punës të montimit të shtyllave të reja dhe rrjetit TU20/0.4kV, etj. Ky raport vlerësimi ka për qëllim:

- Paraqitjen e gjendjes sa më reale, nga pikëpamja e ndikimit të këtij aktiviteti, mbi mjedisin natyror dhe human;
- analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore;
- dhënien e masave zbutëse për zvogëlimin e ndikimeve negative;
- planin e menaxhimit lokal dhe monitorimet për zërat përkatëse.

si dhe tenton për përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit pas ndikimit të mundshëm në mjedis. Ndërtimi i linjës, ndërmerret si një iniciativë, që do të tentojë, përveç sigurimit të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve edhe në:

- Zbatimi i rregullores së sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe MKZ;
- Mbrojtjen nga rreziqet;
- Rritjen e punësimeve në këto nivele;

2.4. METODIKA

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u orientua nga madhësia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës, si dhe vlerat e veçanta të tyre, identifikimi i ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse, duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm të projektit. Në këtë studim identifikohen ndikimet pozitive dhe negative në natyrë dhe në mjediset humane, si dhe është marrë parasysh dhe vlerësimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurrur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive, sidomos në kompesime indirekte mbi komunitetin. Studimi është kryer duke u ndarë në katër faza kryesore:

1. Ngritja e objektivave orientuese të projekt-studimit;

2. Mbledhja e materialit bazë ekzistues dhe atij të formuluar enkas për këtë projekt dhe seleksionimi i saj për përdorim;
3. Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundshme biofizike dhe humane;
4. Hartimi i projektit dhe dorëzimi tek porositësi, si dhe tek subjektet vendim-marrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore, në nivele qendrore dhe lokale;

Nga Institucionet e specializuara, sipas porosisë së ARM/MM mund të kryhen monitorimet si më poshtë:

- Përsa i përket zhurmave, frekuencat e monitorimit do të përcaktohen nga specialistët e kësaj fushe pranë inspektoriateve përkatëse
- Monitorimi i ajrit, nuk ka nevojë të kryhet

Shoqëria investuese do të mirëpresë, ndihmojë dhe lehtësojë, çdo iniciativë vëzhguese mjedisore, që do t'i këshillohet në "lejen mjedisore", në shërbim të së cilës është kryer edhe ky studim. Gjithashtu, inspektimet nga specialistët e autorizuar të shëndetit publik dhe mjedisit do të mbështeten në çdo kohë nga kjo shoqëri për realizimin e auditimeve mjedisore dhe shëndetësore.

2.5. KËRKESAT E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË MJEDISIT

Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, paraqet masa lehtësuese për të minimizuar ose për të ndaluar ndikimet sociale dhe mjedisore të projektit. Këto përfshihen në një Plan Menaxhimi Ambiental (PMA), i cili mund të shihet i detajuar në raport. PMA konsiston në vendosjen e masave lehtësuese, monitoruese dhe institucionale, që do të ndërmerren gjatë ndërtimit dhe operimit për të eliminuar, kompesuar ose për të zvogëluar ndikimet ambientale dhe sociale. Plani, gjithashtu përfshin veprimet, që nevojiten për të zbatuar këto masa. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis përcakton menaxhimin specifik mjedisor e planet monitorues dhe identifikon të gjitha nevojat e raportuara, si dhe afatet.

2.5.1. Vlerësimi i ndikimeve

◆ Vlerësimi i ndikimeve potenciale

Pas identifikimit duhet të parashikohet madhësia dhe natyra e ndikimit në mjedis. Parashikimet bëhen mbi ndryshimet potenciale në çdo parametër mjedisor, si në shmangien e ndotjes së ajrit, zhurmave dhe cilësisë së ujrave.

◆ *Vlerësimi i ndikimeve reale*

Ndikimet reale mund të përcaktohen, duke vlerësuar po këto ndikime ndaj:

- standarteve mjedisore;
- rregullores së shfrytëzimit të tokës;
- preferencave të publikut dhe oponencave të specialistëve;

◆ *Identifikimi i masave zbutëse*

Kur një ndikim vlerësohet si i papranueshëm, atëherë kërkon mjete dhe masa zbutëse dhe mbrojtëse, që përfshijnë ndryshimin e metodave dhe parashikim masash lidhur me kohën e zbatimit, mënyrën dhe mjetet që do të përdoren si:

- Kompesim për burime apo sipërfaqe të dëmtuar;
- Vëzhgim i zbatimit të masave zbutëse;

◆ *Vlerësimi i shumëllojshmërisë së gjallesave, florës dhe faunës*

- Konventa e Diversitetit Biologjik përkufizon shumëllojshmërinë e gjallesave si: "Llojshmërinë e organizmave të gjalla dhe komplekset të cilat ato u përkasin. Kjo përfshin ndryshueshmërinë brenda specieve dhe të vetë ekosistemeve". Matësit e shumëllojshmërisë së gjallesave përfshijnë elementë si ndryshueshmërinë gjenetike brenda specieve, etj.

2.5.2. Identifikimi i ndikimit dhe lehtësimet e propozuara

- Ndikimet e mundshëm pozitivë dhe negativë të projektit të propozuar janë identifikuar dhe matur në masën më të konsiderueshme të mundur. Kapitulli, gjithashtu përfshin informacion mbi masat lehtësuese, që duhen marrë për pakësimin e ndikimeve negative, gjatë montimit të shtyllave dhe rrjetit TU 20/0.4kV, si dhe mbi ndonjë ndikim negativ të mbetur, që nuk mund të lehtësohet. Gjithashtu, ky kapitull identifikon dhe vlerëson shtrirjen dhe cilësinë e të dhënave në dispozicion, të dhënat kryesore për boshllëqet, si edhe paqartësitë e shoqëruara me parashikime.

2.5.3. Identifikimi i ndikimit dhe lehtësimet e propozuar

Ndikimet e mundshëm pozitivë dhe negativë të projektit të propozuar janë identifikuar dhe do të maten në masën më të konsiderueshme të mundur. Gjithashtu, në këtë raport përfshihen informacione mbi masat lehtësuese, që duhen marrë për pakësimin e ndikimeve negative, gjatë

montimit të kabinave dhe rikonstruksionit të kabinave ekzistuese, si dhe mbi ndonjë ndikim negativ të mbetur, që nuk mund të lehtësohet.

2.6. ANALIZA E ALTERNATIVAVE

Alternativat e marra në konsideratë nga VNM mbështetet në studime të tjera të kryer nga grupi teknik për të krahasuar në mënyrë sistematike alternativat e leverdisshme për projektin e propozuar për vendin, teknologjinë, projektimin dhe funksionimin, dhe përfshijnë krahasimin në mënyrë sistematike të alternativave të leverdisshme për projektin e funksionimit, duke përfshirë:

- Alternativën e situatës “pa projekt”, në kuptimin e ndikimeve të tyre të mundshme mbi mjedisin. Kjo punë e mëparshme është baza për përzgjedhjen e projektit të zonës në rajonin e Ndertimit të rrjetit TU me kabëll ABC.
- Alternativën specifike të funksionimit të projektit, ku përfshihen:
 - Pozicionimi i elementeve kyçe të projektit;
 - Alternativat për pozicionimin e sistemeve dhe veprimeve ndihmëse për punimet;
 - Zhvillimi i projektimit të metodave optimale të montimit të shtyllave të reja;
 - Metodatat dhe teknologjitë e funksionimit të objektit.

2.7. PLANI I DREJTIMIT MJEDISOR

Plani i Drejtimit Mjedor të projektit (PDM), përmban bashkësinë e masave të lehtësimit të monitorimit dhe të institucionalizimit, që duhet të merren gjatë zbatimit dhe funksionimit për të eliminuar ndikimet e padëshirueshëm sociale dhe në mjedis, për t'i kompensuar apo reduktuar ato në nivele të pranueshme. Plani, gjithashtu përfshin veprimet e nevojshme, për zbatimin e këtyre masave.

Plani i konsultimit publik dhe publikimit

Plani i konsultimit publik dhe publikimit dokumenton kontaktet ndër agjensive dhe përfshirjen e publikut gjatë procesit të përgatitjes së VNM. Ai identifikon Organizatat Jo-Fitimprurëse (OJF), që veprojnë në zonë dhe diskuton përfshirjen e tyre në proces.



III. KORNIZA LIGJORE EKZISTUESE

3.1. SHQYRTIMI LEGJISLATIV, RREGULLATOR DHE I POLITIKAVE

Siç u përmend edhe më parë, "OSHEE" Sh.A e financon këtë projekt. Ai ka politika dhe procedura specifike për të nxitur mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Këto procedura përfshijnë një proces rishikimi të detajuar mbi ambientin, si dhe përgatitjen e një VNM-je paraprake deri në aprovimin përfundimtar të financimit të projektit.

3.1.1. Kuadri Institucional shqiptar

Shtylla kurrizore për raportet e VNM në fushën legjislative është *Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 për "Mbi mbrojtjen e mjedisit"*. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbi bazën e parimeve, kërkesave, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit.

3.1.2. Ligji Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS"

Ky ligj synon të sigurojë:

- a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara të organeve qendrore dhe vendore, antarëve të publikut, organizatave jofitimprurëse, nëpërmjet një vlerësimi të integruar dhe kohor të impaktit në mjedis të projekteve dhe veprimtarive.

Neni 7 - Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.
2. Dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Neni 10 - Paraqitja e kërkesës për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga zhvilluesi

Zhvilluesi, për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i këtij ligji, paraqet pranë MM, përveç dokumentacionit të kërkuar edhe dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë për projektet e shtojcës II:

- i) projektin teknik të veprimtarisë;
- ii) raportin e ndikimit në mjedis të VNM-së, të hartuar sipas llojit të projektit;
- iii) faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij ligji.

3.1.3. VENDIM Nr. 686, datë 29.7.2015 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE¹

KREU I, zhvillimi i procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i kërkesave të nenit 8, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit (projektidesë), paraqet pranë Ministrisë së Mjedisit kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 1.1 Raportin teknik të projektit të propozuar, I cili përfshin:
 - a) qëllimin e projektit të propozuar;
 - b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
 - c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
 - ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;
 - d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
 - dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
 - e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas

- rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
- h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/ autorizimin/ licencimin e projektit;

1.2 Raportin paraprak të VNM-së, ku përfshihen:

- a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij; c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
- dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
- ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
- f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkuftar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Raporti i paraprak i VNM-së të jetë i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licencuar.

1.3 Aktin e regjistrimit të personit fizik/juridik, sipas legjislacionit në fuqi.

1.4 Një kopje të faturës së pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

2. Dokumentacioni i kërkuar në pikën 1, dorëzohet edhe me CD/DVD, në 10 kopje.

3.1.4. LIGJI Nr.10 448, datë 14.7.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT"

Neni 4 - Sistemi i lejeve të mjedisit

1. Në përputhje me ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:

- b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

2. Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C janë si më poshtë:

- b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga AKM-ja;

Kreu III, "lejet e mjedisit të tipit b" neni 20

Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B.

- Instalimet e kategorisë B pajisen me leje mjedisi të tipit B, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

Shqipëria është palë në Konventa që lidhen me mbrojtjen e specieve në përgjithësi, duke përfshirë dhe ato detare. Janë Konventa e Bernës për florën dhe faunën e egër të Evropës, Konventa Ramsar për ligatinat e rëndësisë ndërkombëtare, të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër. Gjithashtu, ky projekt nuk bie kundër edhe me nenet, që mbështeten në ligjin e Pyjeve dhe Gjuetisë dhe udhëzimet e tij, as me ligjin për përdorimin e fondit pyjor-kullësor. Pas marrjes së lejes së ARM-së, materiali së bashku me dokumentacionin do të dërgohet pranë Ministrisë përkatëse, ku do të merret leja e Mjedisit. Realizimi i detyrimeve, që dalin nga ky projekt mbetet objekt kryesor i punës, së subjektit investues.

3.2. LIGJET, VENDIMET DHE UDHËZIMET E VITEVE TË FUNDIT (2011 -2015)

1. *Programi kombëtar i monitorimit* të mjedisit përcakton treguesit kryesor të gjendjes, impaktin dhe presionin në ajër, ujërat e brendshëm, tokën, zonat bregdetare, detin, pyjet dhe diversitetin biologjik dhe përcakton modalitetet e vlerësimit të tyre.
2. *Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"* dekretuar me dekret ndatë 04.06.2002. Ky ligj jep kriteret dhe normativat e monitorimeve të ajrit.
3. *Ligji Nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit"* që ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.
4. *Ligji Nr. 10 463, datë 22.9. 2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* që ka për qëllim të mbrojtë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet: a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve; b) përmirësimit të efikasitetit të

përdorimit të tyre; c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

5. *Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011, "Mbrojtjen e mjedisit"* që ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.
6. *VKM draft "Për përcaktimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe transitin të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte"* me qëllim mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, si edhe mbrojtja e shëndetit publik, përmes minimizimit të ndikimeve negative nga eksporti i mbetjeve dhe kalimi transit i mbetjeve jo të rrezikshme apo i mbetjeve inerte.
7. **VENDIM Nr. 686, datë 29.7.2015** *"Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"*.
8. **SHTOJCA I** *Kriteret ndihmëse për marrjen e vendimit gjatë procedurës paraprake të vnm-së*

1. Karakteristikat e projektit:

- madhësia e projektit;- efektet kumulative me projekte të tjera;- përdorimi i burimeve natyrore;
- prodhimi i mbetjeve,- volumi i shkarkimit të ndotjes dhe zhurmës në mjedis;- mundësia e aksidenteve me pasoja në mjedis, duke pasur parasysh, substancat apo teknologjitë e përdorura.

2. Karakteristikat e mjedisit në zonën e projektit:

- a) përdorimi ekzistues i tokës së kërkuar nga projekti;
- b) gjendja e mjedisit në zonën ku propozohet projekti, duke i kushtuar vëmendje të veçantë:
 - ligatinave;- zonave bregdetare;- zonave pyjore;- zonave të mbrojtura natyrore, me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare dhe distanca e tyre nga zona ku propozohet projekti;- biodiversitetit të zones dhe statusit të ruajtjes/mbrojtjes;
 - zonat ku janë tejkuluar standardet e cilësisë së mjedisit (të përcaktuara në akte të tjera);
 - zonat me densitet të lartë të popullsisë;

IV. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME

4.1. VLERËSIMI DHE IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE DHE POZITIVE

Si çdo objekt tjetër, që ndërtohet në një mjedis të caktuar deri në arritjen e formës së caktuar ka një sërë punimesh ndërtimi dhe montimi. Funksonimi i aktiviteteve të tilla në këto zona ka veçorinë, që kërkon ngritjen e një infrastrukture të përshtatshme me plane menaxhimi mjedisore gjatë punimeve të ndërtimit dhe gjatë funksionimit, si nga ana vizuale dhe funksionale si:

- sheshin e objektit, i cili sistemohet dhe drenazhohet nga ujrat sipërfaqesore;
- vlerësimin dhe identifikimin e ndikimeve në mjedis për të dy fazat si me poshte:

<i>Lloji i ndikimit në tokë</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Ndryshime topografike të terrenit		x		x
Prishja e tokës bujqësore		x		x
Ndotja e tokës nga rrjedhjet	x			x
Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta		x		x
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave		x		x

<i>Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Prodhimi i areosolave		x		x

<i>Lloji i ndikimit në florën dhe faunës</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore		x		x
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit		x		x
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zonës së virgjër		x		x
Përçarje apo izolim të habitateve të egra		x		x
Interferencë midis rrugës natyrore të emigrimit të sisonëve		x		x
<i>Lloji i ndikimit në ujë</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Trajtimi i ujrave të ndotur		x		x
Ndotja e ujit prej pluhurit, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera	x			x

Impakti sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujrat nëntokësore etj.		x		x
Modifikim në drenazhimin e ujrave natyrore		x		x
Ndotja e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga llumrat	x			x

<i>Lloji i ndikimit në ndotjen nga zhurmat</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave	x			x
Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinave	x			x
Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit		x		x
Niveli më i lartë i zhurmave për kafshët	x			x

<i>Lloji i ndikimit në përfitimin e tokës</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Shkatërrim banesash		x		x
Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës		x		x
Rivendosje banesash		x		x
Shpronësime të tokës		x		x

<i>Lloji i ndikimit për trashëgiminë kulturore</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Ndryshime apo dëmtime të zonave arkeologjike apo me vlerë historike e kulturore		x		x

<i>Lloji i ndikimit në energji</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistuese apo kërkesave të reja të energjisë		x		x

<i>Lloji i ndikimit në interesin publik (infrastruktura)</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Ndryshimi i destinacionit të aktivitetit do të ketë apo jo nevojë për ndryshim në fushë të interesit publik		x		x
Sinjal telefonik		x		x
Sistemin e komunikacionit		x		x
Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre	x			x

<i>Lloji i ndikimit në shëndetin publik</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Krijimi i çfarëdo rreziku apo mundësie për dëmtimin e shëndetit të njerëzve		x		x

Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e mundëshme për dëmtimin e shëndetit publik		x		x
--	--	---	--	---

<i>Lloji i ndikimit në qarkullim dhe transport</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve	x			x
Pakësime të vendqendrimeve të automjeteve apo nevoja për vendqendime të reja		x		x
Ndikime të rëndësishme në sistemin e telekomunikacionit		x		x
Ndryshime në qarkullimin apo lëvizjen e njerëzve	x			x

<i>Lloji i ndikimit nga rrezatimi elektromanjetik</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjatë ndërtimit</i>		<i>Gjatë shfrytëzimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
Krijimi i cfarëdo rreziku apo mundësie rrezatimi për dëmtimin e shëndetit të njerëzve		x		x
Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e rrezatimeve për dëmtimin e shëndetit publik		x		x
Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinave	x			x

Tabela: Vlerësimi i ndikimeve negative më të rëndësishme në mjedis

<i>1.Lloji i ndikimit</i>	<i>2. Faza e përgatitjes së punimeve të gërmimit të gropave</i>	<i>3. Faza e punimeve në rrugët ndihmëse të linjës.</i>	<i>4. Faza e funksionimit të linjese</i>
Ndikime në topografinë e territorit	Të lehta	Të rëndësishme	Të pakonsiderueshme
Rritje e efekteve të erozionit	Të pakonsiderueshme	Të rëndësishme	Të pakonsiderueshme
Varfërimi i shtresës sipërfaqësore nga biomasa	Të pakonsiderueshme	Të pakonsiderueshme	Të pakonsiderueshme

Tabela: Vlerësimi i ndikimeve negative më të rëndësishme në mjediset humane

<i>1.Lloji i ndikimit</i>	<i>2. Faza e përgatitjes së punimeve të gërmimit të gropave</i>	<i>3. Faza e punimeve në rrugët ndihmëse të linjës.</i>	<i>4. Faza e funksionimit të linjese</i>
Shqetësimet nga zhurmat dhe dridhjet gjatë operacioneve të punës	Të lehta	Relativisht të rëndësishme	Relativisht të pa rëndësishme
Shqetësimet nga zhurmat, dridhjet dhe pluhurat gjatë transportit të materialeve	Të pakonsiderueshme	Të rëndësishme	Relativisht të pa rëndësishme
Shqetësimet në burimet ujore dhe agrokultura	aspak	aspak	aspak
Shqetësimet nga mbeturina personale të punonjësve dhe mbetje të paisjeve elektrike	Të lehta	Relativisht të rëndësishme	aspak

4.2. ANALIZA DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE SIPAS ALTERNATIVAVE

4.2.1. Vlerësimi i Alternativës parë "pa projekt"

Kjo alternativë mbetet në konsideratë, duke patur parasysh përshkrimin e mjedisit të dhënë më sipër. Zona ku do të kryhen punime për montimin e shtyllave të reja dhe ndertimi i rrjetit TU 20/0.4kV me kabell ABC përbën një territor të urbanizuar ku pjesa më e madhe është pranë rrugëve kryesore të cilat janë zona për tu stabilizuar nga këndvështrimi urban. Mundësia e mos montimit të shtyllave të reja dhe ndertimit të rrjetit TU 20/0.4kV me kabell ABC, për pasojë mos furnizimin me energji elektrike dhe perballimin e ngarkesave kryesisht gjatë sezonit të verës dhe mos furnizim me energji elektrike të zonës në studim, si dhe mos sistemimin e abonentëve me adresa të sakta dega teknike- sistemi billing, mos eliminimin e mundësisë të abuzimit me energji elektrike të abonentëve keqdashës në keto zona që janë dhe pak larg, qendrës së vezhimit nga punonjësit e kompanisë. Duke përmbledhur sa u tha më sipër u vlerësua që alternativa e "jo-montimit të shtyllave të reja dhe ndertimi i rrjetit TU 20/0.4kV me kabell ABC" do të përfshijë më shumë impakte negative në zone sesa do të shkaktojë operimi i këtij aktiviteti.

Ndikimet kryesore në mjedis në Alternativën e mos montimit të shtyllave të reja dhe ndertimi i rrjetit TU 20/0.4kV me kabell ABC

Objekti mbi të cilin bien	Lloji i ndikimit
Rrjeti ekzistues	- - -, mos perballimin e ngarkesave;
Furnizim me energji elektrike i komunitetit	- - -, mos perballimin e furnizimit me energji elektrike komunitetin;
abuzimi me energji elektrike	- - -, shtohet mundësia e abuzimit me energji elektrike të abonentëve keqdashës
Rrjeti i tensionit të ulet	- - -, jo sipas standarteve dhe parametrave bashkëkohor

4.2.1. Vlerësimi i aktivitetet në dobi të një zhvillimi të qëndrueshëm

Për një pasqyrim më të mirë të ndikimeve do të ndihmojë edhe veçimi i ndikimeve sipas fazave të funksionimit të aktivitetëve.

Aktiviteti i parë – Shërbimi në montimin e shtyllave të reja dhe ndertimi i rrjetit TU 20/0.4kV me kabell ABC

Ky është aktiviteti kryesor, që mendohet se ka ndikimet më të mëdha nga pikëpamja e efekteve momentale. Objektivi themelor i këtij aktiviteti është për permiresime me qellim perballimin e ngarkesave kryesisht gjatë sezonit turistik, me cilësi dhe standart evropian, në mënyrë që ai të

shërbejë realisht për një aktivitet të qëndrueshëm. Brenda këtij objekti, do të zbatohen të gjitha kërkesat për të normalizuar ngarkesat në sistemin e furnizimit me energji elektrike në këto zone, si dhe për të përmirësuar furnizimin me energji të zonës në studim.

Tabelë përmbledhëse e ndikimeve, që gjenerohen nga zhvillimi i aktivitetit

<i>Burimi i Ndikimeve</i>	<i>Objekti mbi të cilin bien.</i>	<i>Lloji i ndikimit</i>
Furnizimi me en. elektrike	Banorët vendas Biznesin vendas	+++ Rritjen e nivelit të tensionit në konsumator
Sistemimi i rrjetit TU 20/0.4 kV sipas standarteve	Banorët vendas Biznesin vendas	+++ Eleminimi i mundësisë së abuzimit me energjinë elektrike të abonenteve keqdashës; +++ Sistemimi i abonentëve me adresë të sakta dega teknike-sistemi billing;
Shfrytëzimi i energjis elektrike në cilësinë dhe standartet evropianë	Banorët vendas Biznesin vendas	+++ Përmirësimin e sistemit të transmetimit në nivelet lokale +++ Rritja e fuqizimi i bizneseve. +++ perballimin e ngarkesave gjatë sezonit turistik
Gjenerimi i mbeturinave	Mjediset urbanë	+, menaxhimi rigoroz i tyre

Shpjegim:

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë
- ? , Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- + , Ndikim pozitiv
- ++ , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++ , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet kërkon një fokusim të gjerë për zbutjen e ndikimeve negative dhe rritjen e atyre pozitivë gjatë aktivitetit. Në këtë aktivitet do të zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit teknik, që mendohet se ka ndikimet më të mëdha, jo vetëm nga pikëpamja e efekteve momentale, por edhe për jetëgjatësinë e saj.

Aktiviteti i dytë – Përmirësimi i mjedisit fizik pas përfundimit të montimit të shtyllave të reja dhe ndërtimi i rrjetit TU 20/0.4kV me kabëll ABC

Ky aktivitet kryhet pranë rrugëve kryesore. Përmirësimi i zonës do të përmirësojë sipërfaqen e gjelbërimit në rajon. Kjo ndërmerret nga firma, si masë zbutëse mjedisore në këtë territor.

Tabelë përmbledhëse e ndikimeve që do të gjenerohen nga përmirësimi i zonës

<i>Burimi i Ndikimeve</i>	<i>Objekti mbi të cilin bien.</i>	<i>Lloji i ndikimit</i>
Mbjellja e drurëve	Ajër, tokë	+++ ruajtja e sipërfaqes së gjelbër në mjedis për përmirësimin e cilësisë së ajrit +++ rritja e sipërfaqes së gjelbër në mjedis për mbrojtjen e tokave nga erozioni.

Ngjeshja e tokës pas mbarimit	Tokë, ujra	++, Rruajtja e topografisë së zonës dhe erozioni ujor;
Mbushja me një shtresë zhavori h = 150 cm	Bazamentet e kabinave	++, mbrojtje e stabilitetit të bazamenteve të kabinave.
Ndërtimi i sistemit drenazhimi përreth gropes	Tokë, ujra	+++ , ruajtja e sipërfaqes ujore nga ndotjet për përmirësimin e cilësisë së ujrave.
Ndryshim i relievit natyror dhe i formës së përdorimit të tokave	Tokë	+, përmirësimi i peisazhit natyror.
Punime për sistemin të shesheve.	Peisazh	+++ , kthimi në gjendjen e më parëshme.

Shpjegim:

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë
- ?, Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- +, Ndikim pozitiv
- ++ , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++ , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet ndikon në rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujrave, por gjithashtu ka një efekt të madh pozitiv, pasi rrit sipërfaqet e gjelbëruara dhe mbrojtjen nga erozioni të zonës përreth, si dhe mbron objektin nga kërcënimet e gjeorreziveve prezente në këtë objekt.

Aktiviteti i tretë - Mbrojtja në punë sipas rregullave të teknikës së sigurimit

Për këto procese ka rregulla specifike, të cilat duhet të respektohen sipas planit të realizimit të aktiviteteve. Është shumë e rëndësishme të zbatohen edhe rregullat e sigurimit teknik, në montimin e shtyllave të reja dhe ndërtimi i rrjetit TU 20/0.4kV me kabell ABC etj.

Tabelë përmbledhëse e mbrojtjes sipas rregullave të sigurimit teknik

Burimi i Ndikimeve	Objekti mbi të cilin bien.	Lloji i ndikimit
Pajisja e punonjësve me veshjet e duhura (maska, kufje kundra zhurmave, veshje specifike etj).	Tokë. Banorët vendas, punonjësit Biznesin vendas	- , ndotje minimale nga gjenerimi i pluhurave (duke marrë parasysh udhëzimet gjatë gjenerimit të pluhurave). - - , Ndotje akustike – shqetësim për punonjësit dhe banorët.
Aksidente të mundshme gjatë procesit të hapjes së gropave në brendësi të tokës	Punonjësit, Banorët vendas	- , Rritja e mundësisë për aksidente.
Shfrytëzimi i fuqisë punëtore	humane	+++ , Rritja e punësimit në komunitet.

Shpjegim:

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë
- ?, Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- +, Ndikim pozitiv
- ++ , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++ , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Punonjësit duhet të pajisen me veshje pune dhe të trajnuar në shërbimin e këtij aktiviteti. Brigada e punonjësve që do të bëjë montimin e shtyllave, duhet të disponojë dokumenta, ku pasqyrohet puna me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullave, e cila do të bëhet e përjavëshme dhe e dokumentuar me firmat përkatëse për njohuritë bazë në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.

Aktiviteti i katërt – Menbaxhimi i mbeturinave gjatë procesit të montimit shtyllave të reja dhe ndertimi i rrjetit TU 20/0,4kV me kabell ABC.

Ky aktivitet në kuadër të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të punonjësve dhe banorëve të cilët ndikohen nga ky projekt nevojitet të zbatohet me rigorozitet sipas udhëzimeve që jepen në këtë raport. Rrethimi i vendit ku do të kryhen punime të gërmimit është hapi i parë që do të merret gjatë nisjes së punimeve. Ndotja nga gjenerimi i pluhurave gjatë hapjes së gropave për bazament të shtyllave do të minimozohet, duke e spërkatur me ujë gjatë gjithë ditës për të mos ndikuar në prodhimin e pluhurave ashtu siç ndodh rëndomë gjatë kryerjes së punimeve të ndryshme nëpër rrugë.


Tabelë përmbledhëse e menaxhimit të mbeturinave të gjeneruara nga ky aktivitet

<i>Burimi i Ndikimeve</i>	<i>Objekti mbi të cilin bien.</i>	<i>Lloji i ndikimit</i>
Hapja e gropave ku do të vendosen bazamente e shtyllave te reja.	Tokë. Banorët vendas, punonjësit Biznesin vendas	- , ndotje minimale nga gjenerimi i pluhurave. - - , Ndotje akustike.
Gjenerimi i mbeturinave	Mjediset urbanë	+ , menaxhimi rigoroz i tyre
Gjenerimi i mbeturinave personale	Punonjësit	++ , Të gjitha mbetjet personale nga konsumimi personal i punonjësve do të menaxhohen me kujdes.

Shpjegim:

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë
- ? , Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- + , Ndikim pozitiv
- ++ , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++ , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ndotja që do të rezultojë nga hapja dhe mbyllja e gropave si edhe nga mbetjet personale që do të gjenerohen nga konsumimi personal i punonjësve do të menaxhohen me kujdes nga kompania përkatëse që do të kryejë punimet.



V. ANALIZA E NDIKIMEVE NË MJEDIS DHE SHËNDETIN NJERËZOR

5.1. ANALIZA E NDIKIMEVE NË MJEDIS

5.1.1. Analiza e ndikimit nga Zhurmat

Në konceptin fizik nuk ka asnjë dallim midis tingullit dhe zhurmës. Tingulli është një perceptim ndjesor dhe konfiguracioni kompleks i valëve zanore është përcaktuar (quajtur) me termat: zhurmë, muzikë, fjalë, etj. Zhurma është përcaktuar edhe si tingull i padëshirueshëm. Të gjitha matjet marrin parasysh përmbajtjen e frekuencës së zhurmës, nivelet e presionit akustik global dhe ndryshimin e këtyre niveleve në kohë. Të dhëna për zhurmat në vend do të krijohen gjatë procesit të punës. Linja projektohet në mënyrë të tillë, që zhurmat e krijuara prej saj do të jenë sipas kritereve të vendosura në rang kombëtar për emetimet e zhurmave. Për të krijuar një ide mbi nivelin e zhurmave po japim një tabelë krahasimore të zhurmave për mjedise të ndryshme.

Niveli Tingullit	Pikënisja dëgjimit	Pëshpërima	Biseda	Trafiku Qytetit	Koncert Rock	Motor Jet 10 m larg
dB(A)	0	30	60	90	120	50

Zhurma nuk do të jetë shqetësim kryesor në zonat rrethuese të vendit të përzgjedhur. Nuk ka burime për emetimin e zhurmave domethënëse në këtë vend përveç se niveleve të zhurmave të zakonshme në një zonë të izoluar në brendësi të një lagje. Niveli i zhurmave krijuar nga ndertimi i kësaj linje pritet të jetë i papërfillshëm dhe jo mbi normat e lejuara, megjithatë rekomandohet që mbas venies në punë të linjes të bëhet monitorimi i zhurmave tek stacioni qendror për efektin e kurores për kushte të ndryshme të motit.

Pluhuri

Në këtë kete aktivitet do të jetë present ekzistenca e pluhurit gjatë ndertimit, sepse do të ketë operacione pune që do të shkaktojnë pluhura, por ndryshe nga shume aktivitete të tjera, ajo nuk do të jetë asnjherë present gjatë funksionimit të linjes elektrike.

5.1.2. Analiza e ndikimit në punimeve të germimit të tokës

Punimet e germimit do të shtrihet pjesërisht në një shesh toke jo të kultivuar me relief topografik fushor, më saktë rrëzë disa rrugëve kryesore të zonës dhe pa probleme natyrore. Kthimi i terrenit të caktuar në sheshe për montimin e kabinave, kërkon investime, dhe e parë në këndvështrimin

ndaj mjedisit është një veprim që kryhet në të, por jo për ta keqësuar, por për ta përmirësuar dhe për ta vënë në shërbim të njeriut, jo vetëm për qëllime të ngushta përfitimi, por edhe në interes të zhvillimit publik. Montimi dhe rikonstruktimin i kabinave të transmetimit të rrjetit elektrik nuk do të krijojë shqetësime për terrenet rreth e rrotull gjatë procesit të punimeve të montimit, pasi objekti nuk përfaqëson punime ndërtimi ose kompleks industrial. Gjatë kohës së montimit të kabinave nuk krijohen dëmtime të tokës, pasi nuk ka mbetje dëmtuese, që të shkarkohen në të, si në sipërfaqen në dispozicion, ashtu edhe përreth. Edhe në rast se ky aktivitet në një të ardhme, për arsye të ndryshme ndërpritet i gjithë sheshi është plotësisht i përdorshëm për çdo qëllim tjetër.

5.2. ANALIZA E NDIKIMIT TE FUSHES ELEKTROMAGNETIKE NË MJEDIS

5.1. 1. Veçoritë kryesore

Një rezultat anësor i këtij zhvillimi është, që njerëzit ndodhen gjithnjë e më shumë të ekspozuar ndaj fushës magnetike, si dhe rrezatimit elektromagnetik për një brez të gjërë frekuencash. *Po cili është veprimi i fushave elektromagnetike në jetën e njerëzve, si dhe në mjedisin rrethues? Dy janë synimet kryesore të këtyre studimeve:*

- Së pari, në vlerësimin e rrezikut të fushave elektromagnetike në jetën e njerëzve dhe të gjallesave të ndryshme dhe përcaktimin e masave për mënjanimin e këtij rreziku.
- Së dyti, në ndikimin në funksionimin normal të pajisjeve të ndryshme.

Ndikimi i fushave elektromagnetike në shëndetin e njerëzve ka qenë objekt i jo pak studimeve. Për më tepër, kjo fushë studimi ka nxitur adaptimin e një metodologjie kërkimore specifike. Në studimet e publikuara deri tani është nënvizuar vështirësia në interpretim të rezultateve për arsye të kufizimeve në përzgjedhjen e kontrolleve. Për shkak të vështirësisë së tyre dhe të pamjaftueshmërisë të të dhënave këto studime nuk kanë arritur në një rezultat përfundimtar. Kështu, përsa i përket frekuencave industriale (50Hz), grupi i punës i NIEHS ka arritur në përfundimin që "ekspozimi ndaj frekuencës të linjave të fuqisë është një burim i mundshëm kancerogjen". Në një përfundim të afërt ka arritur edhe NRPB "Në përgjithësi, eksperimentet laboratorike nuk kanë siguruar prova të qarta, që fushat elektromagnetike të frekuencave tepër të ulta janë të afta për të krijuar kancer, dhe as studimet epidemiologjike mbi njerëzit nuk sugjerojnë, që ato shkaktojnë kancer". Pavarësisht nga mungesa e një lidhje të qartë midis fushave elektromagnetike dhe të disa llojeve të kancerit dhe të sëmundjeve të tjera, komunitetet shkencore janë mjaft të kujdesshme në nxjerrjen e përfundimeve. Për të siguruar

parrezikshmërinë e fushave elektromagnetike në shëndetin e njerëzve, ata në bashkëpunim me organizma ndërkombëtarë kanë hartuar standartet e ekspozimit ndaj fushave elektromagnetike. Këto standarte janë kthyer në ligj nga shumica e shteteve të zhvilluara. Në rastin tone, burim i fushes elektromagnetike do të jete terminallet apo nenstacionet, nderkohe qe futja e tyre nen dhe ben qe te mos kemi aspak ndikim nga keto linja kabllore

5.2. 2. Burimet e fushave elektrike dhe magnetike

Fushat magnetike krijohen nga ngarkesat në lëvizje, të cilat në gjuhën e përditshme quhen rryma elektrike. Sa më e madhe të jetë rryma elektrike aq më e madhe është fusha magnetike. Madhësia e fushës magnetike, e cila varet nga rrymat elektrike, do të ndryshojë me ndryshimin e fuqisë elektrike. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë madhësitë për fushat elektrike dhe magnetike, si dhe njësitë e tyre.

<i>Madhësia</i>	<i>Simboli</i>	<i>Njësia</i>	<i>Simboli njësisë</i>
Intesiteti i fushës elektrike	E	Volt për metër kilovolt për metër	wV/m} wkV/m}
Induksioni i fushës magnetike	B	Tesla militesla mikrottesla nanotesla	wT} wmT} = 10 ⁻³ T wT} = 10 ⁻⁶ T wnT} = 10 ⁻⁹ T
Intesiteti i fushës magnetike	H	Amper për metër	A/m

Induksioni i fushës magnetike B lidhet me intesitetin H me anën e përçueshmërisë magnetike μ , si më poshtë:

$$B = \mu H$$

Për shumicën e materialeve biologjikë, përçueshmëria magnetike është sa e ajrit, për rrjedhojë:

$$1 \text{ T} = 0.8 \text{ A/m}$$

Fushat elektromagnetike janë të pranishme, kudo në mjedisin tonë. Prania e tyre vëzhgohet me anën e aparateve speciale. Ata janë të padukshme nga shqisat e njerëzve. Fushat elektrike dhe magnetike i ndajmë në natyrale dhe të krijuara nga pajisjet e ndryshme. Kështu, fusha elektrike natyrale krijohen gjatë stuhive të shoqëruara me rrufe. Në fushat magnetike natyrale mund të përfshijmë fushën e tokës, fushën magnetike të rrymave të jonosferës, si pasojë e aktivitetit diellor, rrufetë, etj. Organizmat e gjalla janë përshtatur ndaj fushave natyrale. Si shembull mund të përmendim që fusha magnetike e tokës shfrytëzohet nga zogjtë dhe peshqit për t'u orientuar në shtegëtimet e tyre. Fushat elektromagnetike ndikojnë në njerëzit në mënyra të ndryshme. Kështu, fushat elektrike dhe magnetike të frekuencave të ulta, për shkak të gjatësisë së madhe të valës së tyre, ndikojnë në mënyrë të veçantë. Gjatë shekullit XX, ekspozimi ndaj fushave

elektromagnetike ka qenë vazhdimisht në rritje si pasojë e kërkesave në rritje për energji elektrike, avancimit të teknologjisë dhe ndryshimeve në sjelljet sociale të njerëzve, të cilat janë shoqëruar me krijimin e më shumë burimeve artificiale. Çdokush është i ekspozuar ndaj një kompleksi miks të ulët të fushave elektrike dhe magnetike, si në shtëpi ashtu dhe në punë, në nivel të prodhimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gjatë përdorimit të pajisjeve shtëpiake apo pajisjeve industriale, në nivel telekomunikacioni apo transmetimi.

Rryma elektrike të ulëta ekzistojnë në trupin e njeriut gjatë reaksioneve kimike si pjesë e funksioneve normale të trupit, madje dhe në mungesë të fushave të jashtme elektrike. Për shembull, sinjalet nervore realizohen përmes transmetimit të impulseve elektrike. Shumica e reaksioneve biokimike, qofte në aparatit tretës apo në sistemin nervor, realizohen përmes shkëmbimit të grimcave të ngarkuara. Madje dhe zemra ka një aktivitet elektrik, një aktivitet që vihet në dukje përmes elektrokardiogramës. Për studimin e veprimit të fushës elektromagnetike në njerëzit shfrytëzohën madhësitë e tyre E dhe B. Ato veprojnë si mbi çdo material tjetër të përbërë nga grimca të ngarkuara. Të dyja fushat induktojnë rryma elektrike në trupin e njeriut, të cilat në kushte normale janë shumë të vogla, në krahasim me kufirin e lejuar, mbi të cilin shkaktohet goditja elektrike apo ndonjë efekt tjetër. Si pasojë e ekranizimit, fusha elektrike brenda trupit të njeriut është shumë më e vogël se ajo jashtë saj. Trupi i njeriut është "transparent", fusha brenda tij është sa ajo jashtë. Kjo është edhe arsyeja, që përse i përket fushës magnetike numri i studimeve është shumë më i madh se për fushën elektrike. Në fushat e frekuencave të larta, për shkak të gjatësisë së vogël të valës, shfrytëzohet fuqia, që thithet (absorbohet) nga trupi i njeriut. Klasifikimi i fushave elektromagnetike në varësi të frekuencës jepet nëpër tabela.

5.2. 3. Fushat elektromagnetike në frekuenca të ulëta

Si fusha elektrike, ashtu dhe fusha magnetike zvogëlohet me shpejtësi, duke iu larguar burimit të tyre. Prania e një objekti ndërmjet burimit dhe njeriut ndikon shumë në madhësinë e fushës elektrike dhe nëse ky objekt është metalik kemi pothuajse eliminimin e fushës elektrike. Kjo dukuri quhet ekranizim dhe i thjeshton shumë masat për mbrojtjen nga fusha elektrike. E kundërta ndodh me fushat magnetike. Shumë materiale, duke përfshirë edhe ato të ndërtimit janë "transparente" përse i përket asaj. Kështu për shembull, muri i një godine nuk shërben si pengesë për fushën magnetike, siç mund të ishte për fushën elektrike. Të vetmet materiale, që shërbejnë për të kryer një farë ekranizimi (edhe ky jo i plotë) janë materialet magnetikë dhe

ferromagnetikë si hekuri, çeliku etj. Këto karakteristika janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

<i>Fusha elektrike</i>	<i>Fusha magnetike</i>
Mund të jetë e pranishme edhe kur pajisja nuk është në punë.	Ekzistojnë për aq kohë sa pajisja është në punë (ka rryma elektrike).
Madhësia e fushës zvogëlohet me largimin nga burimi.	Madhësia e fushës zvogëlohet me largimin nga burimi.
Fusha elektrike zvogëlohet gjatë kalimit në shumë materiale e sidomos në ato të ndërtimit.	Shumë materiale janë "transparente" për fushën magnetike. Ato ekranizohen vetëm nga materialet ferromagnetike.

Burimi: NRPB "ELF *Electromagnetic fields and the risk of cancer*", 12(1), 2001.

5.2.4. Cilat janë nivelet e fushave magnetike në jetën e përditshme?

Matjet e kryera nga organizma, institute dhe specialistë të ndryshëm në mbarë botën, tregojnë që nivelet e fushave magnetike ndryshojnë gjerësisht, por japin një mesatare të ekspozimit ditor të rendit $0.10 \mu\text{T}$. Kjo vlerë është shumë herë më e ulët se sa kufiri maksimal sipas standartit prej $100 \mu\text{T}$ për publikun dhe $500 \mu\text{T}$ për punonjësit. Gjithashtu, matjet kanë treguar që nuk ka ndryshime të mëdha midis ekspozimit të njerëzve, që jetojnë në qendrat e qyteteve dhe atij të njerëzve, që jetojnë në periferi të qyteteve apo në zonat rurale. Madje, ekspozimi i njerëzve, që jetojnë në afërsi të linjave të tensionit të lartë ndryshon shumë pak nga mesatarja e ekspozimit për popullsinë. Kjo vjen nga që njerëzit janë të ekspozuar ndaj fushave të paisjeve elektroshtëpiake, madhësia e të cilave në mjaft raste është e krahasueshme me atë të fushës së linjave të fuqisë.

5.3. ANALIZA E RREZIKUT TE FUSHES ELEKTROMAGNETIKE NË SHËNDET

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë disa nga burimet më të zakonshme të fushave elektromagnetike. Të gjitha vlerat tregojnë nivelet maksimale të ekspozimit të publikut.

<i>Burimi</i>	<i>Maksimumi tipik i ekspozimit publik</i>	
	<i>Fusha elektrike (V/m)</i>	<i>Densiteti i fluksit magnetic (μT)</i>
Fushat natyrale	200	70 (fusha magnetike e tokës)
Linjat kryesore (në shtëpi jo afër linjave)	100	0.2
Linjat kryesore (nën linjat)	10 000	20

Trupi ka mekanizma të sofistikuar për t'u përshtatur ndaj shumë ndikimeve që takojmë në mjedis, megjithëse veprimet e ndryshimeve përbëjnë një pjesë normale të jetës sonë. Por,

sigurisht që trupi ynë nuk zotëron mekanizma kompensues të përshtatshëm për të gjithë efektet biologjike. Gjithmonë ndryshimet, që janë të pakthyeshem dhe stresojnë sistemin fizik e mendor të njeriut gjatë një periudhe të gjatë kohe përbëjnë rrezik shëndeti. Ende diskutohet fakti, që fushat elektromagnetike, kur tejkalojnë normat mund të çojnë në lindjen e efekteve biologjike. Shkencëtarët janë duke studjuar efektet e ekspozimit për një kohë të gjatë në nivele të ulëta (nën nivelin prag të ngrohjes trupore). Të dhënat nuk konfirmojnë, por as nuk përjashtojnë, efekte të dëmshme në shëndet (psh mutacione etj.) nga ekspozimi për një kohë të gjatë ndaj niveleve të ulëta të fushave elektromagnetike. Eksperimentet e kryer në punonjës të ekspozuar në fushat e induktuara në nënstacione elektrike kanë treguar, që ekspozimi, për një afat të shkurtër në nivelet aktuale të fushave elektrike dhe magnetike nuk shkaktojnë ndonjë efekt të dëmshëm të dukshëm. Sidoqoftë, për të parandaluar dëmtimet në shëndetin e njerëzve dhe të punonjësve nga nivelet e larta të fushave, organet legjislativë dhe ekzekutive duhet të veprojnë me anën e ligjeve, urdhërave dhe të udhëzimeve. Në ditët e sotme mbetet i hapur problemi i ekspozimit afatgjatë në fushën elektromagnetike, e cila ndonëse në nivele të ulët, mund të shkaktojë reagime (mutacione, etj.) biologjike, si dhe ndikime në shëndetin e njerëzve.

Simptomat e raportuara nga personat e ekspozuar ndaj fushave elektromagnetike përfshijnë: dhimbje koke, ankth, depresion, të vjella, lodhje, konvulsione, kriza epileptike. Gjithashtu ekzistojnë raportime për iritimin të syve dhe katarakt tek punëtorët që punojnë në nivele të larta të mikrovalëve, por studimet në kafshë nuk e mbështesin idenë që forma të tilla të dëmtimit të syve mund të riprodhohen nga nivele ekspozimi nën rrezikun termik. Gjithashtu, raportohet një nivel jo i neglizhueshem i prematuritetit dhe peshës së ulët në lindje tek femijët e punëtorëve që punojnë në industrinë elektronike.

Studimet shkencore ende nuk mbështetin lidhjen midis këtyre simptomave dhe ekspozimit në fushën elektromagnetike. Disa prej këtyre problemeve shëndetsore mund të shkaktohen nga zhurmat ose faktorë të tjerë në mjedis, nga ankthi i lidhur me praninë e teknologjive të reja, etj. Një sërë studimesh epidemiologjike kanë vëzhguar një rritje të vogël të rrezikut të leuçemisë tek femijët, të cilët kanë banuar pranë linjave dhe nënstacioneve, duke qenë kështu të ekspozuar në fushat elektrike dhe magnetike tyre. Disa individë shfaqin "hiperndjeshmëri" ndaj fushave elektrike ose magnetike. Ata pyesin, nëse dhimbjet e kokës, depresioni, letargjia, çrregullimet në gjumë, si edhe spazmat apo krizat epileptike mund të shkaktohen nga ekspozimi ndaj fushave elektromagnetike. Ka prova të pakta shkencore që të mbështetin hiperndjeshmërinë ndaj fushave

elektromagnetike, kur akoma nuk është zbuluar ndonjë mekanizëm i pranuar biologjik, që të spjegojë hiperndjeshmërinë.

5.4. STANDARTET E SOTME TE FUSHES ELEKTROMAGNETIKE

Standartet vendosen për të kufizuar nivelet e fushave elektromagnetike deri në kufij të padëmshëm për shëndetin e njerëzve, për të minimizuar ndikimin në mjedisin përrreth dhe për të siguruar një funksionim normal të pajisjeve. Çdo shtet ka standartet e veta për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike. Është për t'u theksuar, që para viteve '90, standarte të tilla kishin vetëm vendet e zhvilluara dhe kryesisht për rrezatimet për frekuencat e larta. Vendi ynë nuk i ka akoma standartet për ekspozimet ndaj fushës elektromagnetike, si dhe legjislacionin përkatës. Pjesa më e madhe e standarteve në shtetet europiane bazohen në direktivat e dala nga Komisioni ndërkombëtar për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues (ICNIRP). Kjo është organizatë joqeveritare, e cila formalisht miratohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Ajo grumbullon dhe analizon rezultatet shkencore në të gjithë botën. Duke kryer një rishikim të thellë të literaturës, ICNIRP harton direktiva dhe rekomandime për kufijtë e ekspozimit për fusha të caktuara. Këto direktiva përsëriten periodikisht dhe freskohen në qoftë se është e nevojshme. Direktiva më e rëndësishme është ajo e vitit 1998 (Guidelines for limiting exposure ton time-varying electric, magnetic, and electromagnetic fields), e cila përbën thelbin e rekomandimeve të Këshillit të Bashkimit European të vitit 1999 (Council recommendation of 12 July 1999 on the limiting of exposure of the general public to electromagnetic fields). Në tabelat e mëposhtme po japin nivelet e referencës për fushat elektrike dhe magnetike për publikun e gjërë dhe për punonjësit (sipas ICNIRP).

Brezi i frekuencave	Fusha elektrike E ëv/m]	Fusha magnetike H ëA/m]	Fusha magnetike B ë[T]
deri 1 Hz	-	3.2×104	4×104
1-8 Hz	10 000	3.2×104/f2	4×104/f2
8-25 Hz	10 000	4000/f	5000/f
0.025-0.8 kHz	250/f	4/f	5/f
0.8-3 kHz	250/f	5	6.25
3-150 kHz	87	5	6.25
0.15-1 MHz	87	0.73/f	0.92/f
1-10MHz	87/f1/2	0.73/f	0.92/f
10-400 MHz	28	0.073	0.092
400-2000 MHz	1.375f1/2	0.0037f1/2	0.0046f1/2
2-300 GHz	61	0.16	0.20

Brezi i frekuencave	Fusha elektrike E ëv/m]	Fusha magnetike H ëA/m]	Fusha magnetike B ë[T]
deri 1 Hz	-	1.63×105	2×105
1-8 Hz	20 000	1.63×105/f2	2×105/f2
8-25 Hz	20 000	2×104/f	2.5×104/f

0.025–0.82 kHz	500/f	20/f	25/f
0.82–65 kHz	610	24.4	30.7
0.065–1 MHz	610	1.6/f	2.0/f
1–10MHz	610/f	1.6/f	2.0/f
10–400 MHz	61	0.16	0.2
400–2000 MHz	3f1/2	0.008f1/2	0.01f1/2
2–300 GHz	137	0.36	0.45

Në të dy tabelat me "f" është shënuar frekuenca, sipas shtyllës së brezit të frekuencave. Duke patur parasysh në nivelet e fushave elektrike dhe magnetike zvogëlohen me shpejtësi me rritjen e largësisë si dhe matjet e kryera nga specialistë të ndryshëm në botë dhe në vendin tonë (këto të fundit të publikuara) mendojmë që madhësitë e këtyre fushave pas zonës tampon (rrugës me gjerësi 6m) do të jenë shumë më poshtë niveleve të pranuar në këtë raport, për rrjedhojë nuk paraqesin asnjë rrezikshmëri për njerëzit që punojnë apo banojnë rrotull linjës.

5.5. ANALIZA E NDIKIMEVE TË ZHURMAVE NË SHËNDET

Me zhurmat janë të lidhura dhe shqetësimet nervore, streset dhe pagjumësia. Zhurmat mund të shkaktojnë çrregullime të gjumit, çrregullime të komunikimit, dëmtime në dëgjim, efekte kardiovaskulare, efekte psikologjike, mërzi të deri në ndryshime të sjelljeve sociale. Ekspozimi për pak kohë në zhurma më shumë se 140dB(A) sjell shurdhim të menjëhershëm. Ndërsa ekspozimi për disa vjetë në zhurma mbi 85 dB(A) sjell një shurdhim gradual. Ekranet akustikë të qarkullimit si dhe përdorimi i materialeve kundra zhurmave në ndërtim, ulin nivelin e dëgjimit të zhurmave nga 5-15dB. Por, përdorimi me efikasitet i brezave të gjelbër dhe shpërndarjes së gjelbërimit rreth dhe brenda zonës së nënstacionit dhe zonave të shtyllave merr rëndësi të veçantë. Mbjellja e brezave të dendur të gjelbërimit bën që në një largësi rreth 1km, niveli i zhurmave të prodhuara (95dB) të zbrësë në kufijtë e një bisede normale. Jo vetëm kaq, por në ambjentet me zhurmë çënohen më shumë njerëzit që punojnë në të.

VI. PLANI I ZBUTJES SË NDIKIMEVE NEGATIVE

6.1 TË PËRGJITHSHME

Ndikimet negative kërkojnë hartimin e masave zbutëse dhe rikuperimet për ndikimet negative dhe kjo realizohet me anë të tre metodave të mundshme: *Evitimi* ose parandalimi i ndikimit; *reduktimi* ose korigjimi i ndikimit; dhe *kompensimi* ose shlyerja e ndikimit. Lloji i rekomanduar i zbutjes së ndikimit ka mundësi të varet nga një sërë faktorësh, përfshirë zbatueshmërinë teknike, praktikitetin, resurset dhe kapacitetin e disponueshëm, koston dhe nëse rikuperimi i propozuar është konsistent me planin ose programin e propozuar.

6.1.1 Evitimi ose parandalimi

Parandalimi i ndikimeve negative është opsioni i parë dhe më i miri, në rast se është në linjë me qëllimet e tjera të programit të propozuar. Parandalimi funksionon më mirë kur zbatohet herët në procesin e vendimmarrjes dhe në një nivel strategjik. Sapo janë marrë vendimet kryesore në lidhje me një program të propozuar (psh në rastin e zhvillimit të tokës – shkalla e zhvillimit, vendndodhja dhe lloji i përdorimit i propozuar), rikuperimi ka më shumë mundësi të fokusohet në reduktimin ose shmangien e ndikimeve.

6.1.2 Reduktimi ose korigjimi

Reduktimi i ndikimeve negative ka mundësi të jetë metoda më e zakonshme. Dëmtimi në mjedis mund të jetë i pranueshëm, por kur mbahet brenda kufijve të pranueshëm. Korigjimi i ndikimeve negative është i ngjashëm me reduktimin, përveçse kryhet pasi kanë ndodhur ndikimet, për shembull rimbjellja e vegjetacionit të dëmtuar.

Masat për parandalimin dhe reduktimin e efekteve negative do të jenë:

- me karakter teknik;
- me karakter organizativ dhe operacional;
- kontroll e monitorim në kohë.

6.1. PLANI I MENAXHIMIT TË AMBIENTIT

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PNM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet. Duhet theksuar që Plani I menaxhimit të mjedisit është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave.

Plani i menaxhimit të ambientit do të përqëndrohet dhe fokusohet në mënyrë që të garantohen kushte normale të shfrytëzimit të linjës, në furnizimin me energji elektrike të banorëve të kësaj zone, si dhe në permiresimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas standarteve bashkohore në furnizimin me energji të kësaj zone.

6.2. MASAT E SHMANGIES SË NDOTJES SË AJRIT

Ndotja mund të vijë, si nga pluhuri i ngritur nga ngarkesat gjatë qarkullimit të automjeteve, ashtu edhe nga rritja e lëvizjes së mjeteve të motorizuara dhe të rënda. Masat për uljen e nivelit të pluhurave të gjeneruara nga transporti apo depozitimi janë të njëjta me ato të propozuara për reduktimin e ndotjes së ujërave me lagje dhe me mirëmbajtjen e cilësisë së vendit të punës. Por këtu duhet të theksohet se ky tip ndotje është shumë i kufizuar, pasi ndodh vetëm në periudhën kohore të gërmimit të bazamentit të kabinave.

6.3. MASAT E SHMANGIES SË NDOTJES SË UJRAVE SIPËRFAQËSORE

Eksperienca e deritanishme ka treguar se këto kabina nuk kanë qenë shqetësim për ndotjen e mjedisit përreth, për cënimin e shëndetit të banorëve përreth, megjithëse distanca e shtëpive të banimit nga kabinat është më se normale.

6.4. MASAT E SHMANGIES SË NDIKIMEVE NEGATIVE NË BIODIVERSITET

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga dridhjet, pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi, siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin dhe ujin. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të kryhen punime, habitateve të fragmentizuara do të merren masat si më poshtë:

- Së pari do të bëhet mbjellja e tij me metodën e mulcimit atje ku është e mundur, që është e njohur nga punonjësit e shërbimit pyjor në rrethet. Ndonëse për specien që do të mbillet duhet së pari konsultim me ta.
- Nga ana tjetër, lënia e distancave nga fidani në fidan do të jetë rreth 5m, e cila garanton diellzimin e nevojshëm dhe nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonën përreth.
- Pas mbjelljes, fidanët për një periudhë 2 vjeçare do të ruhen (mbrohen) nga investitori, prej kullotjes. Sidoqoftë duhet thënë se mbjellja çdo 5m lejon përllogaritjen e një humbje normale (eficensa e mbjelljes), e cila arin 20% nuk dëmton në mënyrë të rëndësishme rehabilitimin e habitatit dhe sistemimin e tokës, pasi si ushqimi i tokës edhe mulcimi nxisin mbirjen e bimëve spontane.
- Rritja e vegjetacionit autokton do të nxisë edhe afrimin e faunës së përshtatshme për këtë vegjetacion, çka përputhet me faunën autoktone të zonës.

6.5. MASAT E SHMANGIES SE NDIKIMEVE NË INTENSITETIN E EROZIONIT

Masat zbutëse kundër erozionit janë të dy niveleve kryesore, si masa hidroteknike dhe ajo biologjike, duke realizuar:

- mbajtjen e brezave me sipërfaqe, me gjelbërim të përhershëm për rreth pikave të kabinave, që do të ndërtohen në kete zonë.
- menaxhimin dhe kontrollin e erozionit shtresor, duke përdorur me efikasitet përkuqjesjen ndaj fidanëve të mbjellë në vite;



6.6. MASAT NE REDUKTIMIN E MBETJEVE DHE EMETIMEVE NË MJEDIS

6.6.a. Mbetje të ngurta

Nga procesi i montimit të kabinave dalin shumë pak mbetje të ngurta, të cilat janë:

- ✓ Copa kartoni dhe etiketë letre të dëmtuara
- ✓ Mbetje inerte gjatë betonimit të bazamentit

Këto do të jenë në sasi të vogla dhe nuk do të jenë të ndotura me lëndë të dëmshme për mjedisin. Këto mbetje do të hidhen në koshat e mbetjeve dhe do të përfundojnë në kontener të mbetjeve bashkiake.

6.6.b. Mbetje të tjera të ngurta

Si mbetje të tjera të ngurta mund të klasifikojmë:

- ✓ mbetjet e ndryshme ushqimore, si rezultat i veprimtarisë jetësore të njerëzve që do të punojnë aty;
- ✓ mbetjet e ndryshme të aktivitetit të furnizimit me lëndë përdoruese si kablllo, rrota druri etj., që dhe këto do të grumbullohen në kosha e zona të caktuara;

6.6.c. Mbetje të gazta

Mendohet se nuk do të gjenerohen mbetjet e gazta gjatë punimeve të montimit, mbasi nuk do të ketë aktivitete me djegie, me përjashtim të rasteve kur mund të ndodhë avari, zjarre etj.

6.7. MASAT NE MBROJTJEN NGA AKSIDENTET NË PUNË

1. Para së gjithash me marrjen në dorëzim të të gjithë dokumentacionit teknik e administrativ, Shoqëria "OSHEE" sh.a. duhet të marrë të gjitha masat e organizimit në drejtim të plotësimit me rigorozitet të rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë.
2. Për këtë në territorin e linjës duhet të vihen shenja dalluese, të cilat bëjnë të qartë se këtu kemi të bëjmë me zone punimesh instalimi të linjave elektrike gjatë montimit dhe në shtyllat dhe kabinat të linjës elektrike vendoset tabela dalluese të rrezikshmerise.
3. Gjatë kryerjes së aktivitetit në linjë duhet të kemi parasysh çështje thelbësore që përmendëm në kapitullin e punimeve teknike, si dhe zbatimin me përpikmëri i rregullores së sigurimit teknik në linjë. Punimet të kryhen konform këtij projekti.
4. Para fillimit të punës duhet të kontrollohet fronti i punës në çdo post pune, kontrolli i gjendjes dhe gadishmërisë së linjës.
5. Në objekt të vendosen tabelat e sigurimit teknik që kufizojnë punonjësit apo të huaj për kalimin me vend e pa vend, rrugët e detyrueshme të kalimit për ruajtjen nga ndonjë aksident i mundshëm gjatë veprimtarisë operacionale të linjës.
6. Punimet në linjë drejtohen nga një specialist i fushës.
7. Punonjësit duhet të pajisen me veshje pune gjatë orarit të punës.
8. Në linjë duhet të disponohen dokumenta, ku pasqyrohet puna me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullave, e cila do të bëhet e përjavshme dhe e dokumentuar me firmat përkatëse për njohuritë bazë në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.

6.8. MASAT SOCIAL-EKONOMIKE

Zvogëlimi i ndikimeve social ekonomike nga projekti i zbatimit të linjës në studim përfshin përpjekjet për shmangien e keqkuptimeve për punësim afatgjatë të punëtorëve lokalë, edukimin e popullatës mbi natyrën jo spekulative të funksionimit të projektit në fjalë, duke patur parasysh kompesimin si dhe trajtimin me respekt të banorëve të zonës. Operatori, ka bërë dhe po vazhdon të bëjë një punë të planifikuar dhe të kujdesshme, ku operon kjo linjë. Për çdo të papritur që mund të ndodh gjatë zbatimit të projektit, operatori ka marrë masa të lajmërojnë autoritetet e pushtetit vendor dhe të veprojnë në përputhje me ligjin Shqiptar në fuqi.

VII. MASAT KOMPENSUESE DHE MONITORIMI

7.1. MASAT KOMPENSUESE

7.1.1. Masat paraprake për zbutjen e rreziqeve nga zjarret

- Rreziku i zjarrit si pasojë e punimeve të montimit të shtyllave te reja dhe ndertimi i rrjetit TU 20/0.4kV me kabell ABC në mjedis nuk është i pranishëm,

7.1.2. Masat për të ruajtur ekuilibrin ambiental do të meren këto masa:

- Hapjen dhe pastrimin (mirëmbajtjen) e kanaleve kolektorë, gjatë gjithë gjatësisë përreth (anash shesheve të kabines shtyllore) për moslejimin e hyrjes së rrjedhjeve ujore e të mbatjeve të ngurta në territorin përreth kabinave dhe daljen prej tyre drejtpërsëdrejti në rrjedhjen e ujrave sipërfaqësore. Thellësia e kanalit të shkarkimit të ujrave plotëson kushtet e projektit dhe tendenca e tij është në funksion të topografisë së zonës.
- Respektimin e formave të relievit ekzistues në zonat përreth.
- Ngjeshja e tokës pas perfundimit të germimit të gropave.
- Mbushja e dyshemes së gropave me një shtresë zhavori me $h = 1.50$ m.
- Ndertimi i një sistem drenazhimi perreth gropes në tokat ujembajtese.
- - te zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytezimit teknik
- Kthimi në gjendjen e me pareshme të vendeve ku do kryehen punimet, pas perfundimit të tyre.

7.1.3. Të merren masa për mbatjen në gjendje të mirë teknike si:

- Shtyllave dhe rrjetit TU 20/0.4kV me kabell ABC;
- Të bëhet shërbimi periodik në pajisjet që do të montohen;
- Pas çdo punimi remonti apo shërbimi teknik të bëhen akte përkatëse dhe të regjistrohen këto punime;

Herë pas here edhe mund të kryhen;

- kontrolli sanitar i personelit;
- identifikim i efekteve në mjedis, që do të jenë të vazhdueshme dhe të detyrueshme.
-

7.2. PLANI I MONITORIMIT

7.2.1. Plani i monitorimit

Monitorimi është procesi i zbulimit të ndryshimeve, nëse ato do të ndodhin, i përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes të tyre. Objektivi themelor i këtij kapitulli është që të ofrojë rekomandime të përshtatshme për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të mbrojtjes së ekspozimit nga zhurmat, në mënyrë që ai të shërbejë realisht për promovimin publik të gjithë zonës përreth. Procesi i monitorimit do të përqëndrohet dhe fokusohet në këtë aktivitetet, faktorët që gjenerojnë ndikime negative në mjedis, në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Parametrat që do të monitorohen:

1. Gjendja shëndetësore e punonjësve:
 - i. Numri i ditëve me raport për shkak të sëmundjeve profesionale.
2. Sasia në masë dhe vëllim të mbeturinave mujore
 - i. letër
 - ii. plastike
3. Sasia e energjisë së harxhuar mbi baza mujore
 - i. Energji elektrike
 - ii. Sasia e karburantit të gjeneratorit
 - iii. Sasia e karburantit të përdorur nga makinat e transportit të mallrave.
4. Sasia e ujit e konsumuar mbi baza mujore
 - i. Ujë për procesin teknologjik të larjes
 - ii. Ujë për konsum për punonjësit.
5. Niveli i ndotësve në ajrin e mjediseve të brendshme
 - i. PM₁₀
 - ii. PM_{2.5}
 - iii. Pluhur total
6. Niveli i zhurmave ditën gjatë orarit të punimeve
7. Sasia e rrezatimit dhe parametrat e fushës elektromanjetike
 - i. Mbjellja me bimësi

Gjatë funksionimit të monitorohen:

- ii. madhësia e fushave elektromanjetike dhe kryesisht manjetike për të përcaktuar zonat, ku kjo fushë kalon normat, për të parandaluar punonjësit të mos rrinë më shumë se dy orë në këtë zonë.

Monitorimet do të kryhen nga vetë investitori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse. Verifikimet e monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si ARM-ja e Durrësit /Ministri e Mjedisit.

7.2.2. Faza zbutëse të ndërtimit dhe aktiviteti

Ndikimet negativë të parashikuar nga punimet e montimit mund të minimizohen. Ky seksion diskuton masat zvogëluese për ndikimet negativë nga ndërtimi nëpërmjet operimit. Një kosto paraprake për masat prezantohet gjithashtu në këtë seksion. Masat zbutëse për fazat operuese përmbledhen në tabelat e mëposhtme. Këto tabela identifikojnë masat zvogëluese, që duhet të zbatohen për të minimizuar efektet e parashikuar për çdo veprimtari. Të gjithë aspektet e planit zbutës përfshihen në praktikatat e mira të inxhinierisë dhe praktikatat më të mira të menaxhimit dhe si rezultat është e përfshirë në kostot aktuale të projektit.

Aktiviteti	Efektet potenciale	Plani i zvogëlimit	Përgjegjësi	Kostoja e përafërt
Vendi i punës i pastër dhe shkallëzimi	Mungesë pemësh	Pemët nuk do të preken nga vendi i punës. Asnjë pemë që nuk ka lidhje me vendin e punës, nuk do të pritet. Pemët që do të priten do të bëhen të disponueshme për banorët e zonës.	Komp Kontraktor	\$400
Vendi i punës i pastër dhe shkallëzimi	Ndërhyrja në dranazhimin e vendit dhe të erozionit të tokës	Shkallëzimi final i vendit do të lehtësojë dhe do të shmang përmbytjet dhe pellgjet. Një plan dranazhimi i vendit do të bëhet për mbrojtjen nga erozioni. Ruajtja e rezervave nëpërmjet përdorimit të rrethimit dhe zvogëlimi i këndeve të rrëshqitjes do të minimizoj erozionin e tokës gjatë ndërtimit.	Komp Kontraktor	\$1000
Vendi i punës i pastër dhe shkallëzimi	Zhurma nga paisjet	Paisjet e ndërtimit duhet të jenë sipas direktivave standarte të Komunitetit Europian 2000/14/EC të maj 2000. Kjo Direktive aplikohet tek prodhuesit e paisjeve, që bëjnë zhurma. Zhurma gjatë punës duhet të minimizohet gjatë kohës së pushimit dhe të natës. Të gjitha paisjet duhet të mbahen në kushte të mira.	Komp Kontraktor	Të vogla
Përmirësimi i vendit të punës dhe të rrugëve	Pluhuri	Vaditja e sipërfaqeve të vendit të punës, ashtu siç nevojitet do të minimizojë pluhurin. Të gjitha paisjet duhet të mbahen në kushte shumë të mira.	Komp Kontraktor	\$500
Kullimi	Ndotja nga mbetjet	Atje ku gërmimet kërkojnë kullimin. Uji i tepërt duhet inspektohet për përmbajtje ndotësish përpara derdhjes në sistemin e kullimit.	Komp Kontraktor	\$500
Vendndodhja e territorit të marrë	Konfliktet me përdoruesin aktual të tokës	Zona e marrë duhet të shmangë sipërfaqet bujqësore	Komp Kontraktor	Të vogla

Vendndodhja e territorit të marrë	Problemet me komunitetin	Të gjitha lejet dhe aprovimet duhet të merren nga autoritetet e duhura përpara operimit në vend.	Komp Kontraktor	\$2,000
Vendndodhja e territorit të marrë	Sipërfaqet e zëna më aktivitet	Sipërfaqet e marra duhet të ripunohen për tu përzier me ambientin përreth. Ribimësia duhet të kryet në përputhje me bimësinë lokale. Të gjitha pjerrësitë dhe vendet e punës të kthehen në kushte të qëndrueshme.	Komp Kontraktor	\$4,000
Caktimi i vendit për materialet e gërmuara në është e nevojshme.	Ndërhyrja në kullimet natyrale	Shuma e materialeve të predispozuara duhet të minimizohen nga marrja vetëm atë që duhet.	Komp Kontraktor	Të vogla
Caktimi i vendit për materialet e gërmuara në është e nevojshme.	Shqetësimet me tokën	Autoritetet lokale duhet të aprovonë vendodhjen e caktuar. Ajo nuk duhet të ndërhyjë me tokën lokale në përdorim. Bimësia duhet të kryhet në përputhje me bimësinë lokale. Të gjitha pjerrësitë dhe vendet e punës të kthehen në kushte të qëndrueshme.	Komp Kontraktor	\$2,000
Ndërlidhja e sistemit të transmetimit	Shqetësimet me tokën.	Asnjë tokë bujqësore nuk preket nga linjat e transmetimit. Për tokat private duhet të ndiqen procedurat që bazohen në ligjin shqiptar No. 8561, datë 12/22/99; në dekretin e qeverisë No 125, datë 3/23/00; dekretin e qeverisë No 138, datë 3/23/03, dekretin e qeverisë No 147, datë 3/31/00	Komp Kontraktor	Të vogla
Sigurimi i ujit të pijshëm	Zvogëlimi i furnizimit me ujë në zonat e banuara	Furnizimi me ujë që do të përdoret në montimin e kabinave duhet të monitorohet për të siguruar se ai nuk ndikon ujërat e tjerë në këtë territor.	Komp Kontraktor	\$500
Burimet e agregatit	Zvogëlimi i burimeve lokale	Nuk do të ketë burime të tjera. Do të përdoren dherat e gërmuara për mbulimin e gropave të bazamentit të kabinave.	Komp Kontraktor	Të vogla
Forca ndërtuese	Fluksi i punëtorëve që krijon presion në shtëpitë dhe burimeve të tjera	Fluksi i të punësuarve nuk do të kalojë 10-20 persona. Punëtorët duhet të jenë banorë të zonës përreth dhe do të sillen me autobus në vepër. Një qendër e ndihmës së shpejtë do të sigurohet për punëtorët në vepër.	Komp Kontraktor	\$1,000
Shpërndarja e paisjeve dhe e materialeve	Rritja e trafikut dhe e pluhurit	Pluhuri i rrugës do të minimizohet me vaditjen e rrugës gjatë montimit të kabinave dhe duhet siguruar rrugë këmbësorësh. Shpejtësia në rrugë duhet të kontrollohet për të zvogëluar rrezikun e aksidenteve.	Komp Kontraktor	\$1,000
Vend të caktuar për mbeturinat solide	Problemet potenciale të shëndetit	Mbeturinat solide duhet të hiqen nga një kontraktor i licencuar.	Komp Kontraktor	\$2,000
Vend të caktuar për mbeturinat e lëngëta	Ndotja potenciale e ujit	Nuk do të lejohet shkarkesë direkte e ujërave të mbetur por do të shtohet një degëzim dhe do të lidhet me magjistralin kryesor.	Komp Kontraktor	\$1,000
Gërmimi i gropave të kabinave dhe i	Problemet e burimeve ujore	Mbeturinat nga ndërtimi nuk do të hidhen në vend e pavend.	Komp Kontraktor	\$1,000

derdhjeve ujore				
Vendndodhja finale	Estetika	Tokat do te gjelbërohen në mënyrën më të përshtatshme.	Komp Kontraktor	\$1,000

7.2.3. Plani i monitorimit për ndërtim

Aktiviteti	Parametrat e monitoruar	Përgjegjësi
Puna në shesh Pastrimi dhe Nivelimi	Praktika e ndarjes së punës për pastrim, e cila duhet të monitorohet	Komp Kontraktor
Puna në shesh Pastrimi dhe Nivelimi	Mbrojtja e furnizimit nëpërmjet pikave të kontrollit dhe reduktimi i vlerësimeve sipas pikave të tyre për të minimizuar ndotjet e shkaktuara gjatë gërmimeve që duhen monitoruar për të siguruar praktikën sipas planeve të përdorur.	Komp Kontraktor

7.2.4. Cilësia e ajrit

Parametrat e mëposhtëm duhen të monitorohen gjatë ndërtimeve:

- Hi-Vol Ndotje
- Ndotja nga trafiku

